



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë
Bachelor në “Menaxhim Turizmi”
“Universiteti Ismail Qemali, Vlorë”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Asoc. Dr. Etleva Leskaj

Prof.Asoc. Dr.Vita Koja

Shtator/2020

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për Programin e studimit: Bachelor në “Menaxhim Turizmi”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Biznesit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Menaxhim Turizmi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Vendim i Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 105, datë 28.02.1994 me kohëzgjatje 4 vite
5	Urdhëri/Vendim/VKM i riorganizimit:	Vendimin e Këshillit të Fakultetit, shkresë nr 121 prot datë 22. 07. 2009, është riorganizuar programi i studimit nga 4 vjet, me kohëzgjatje normale 3 vjet.
6	Regjistrimi i formës së diplomës:	UMASR Nr. 439, datë 09.09.2011
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	S’ka
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	JO
13.1	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
13.2	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
14	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
15	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Për vitin akademik 2019-2020 Stafi akademik përbëhet nga 28 pedagogë nga ku 27 pedagogë efektivë (PAE), dhe 1 pedagog me kontratë (PAK) Mbulimi i programit në përqindje është, 96% PAE / 4% PAK.
16	Numri i studentëve:	71 Studentë
17	Komente / të tjera:	UMASR Nr. 439, datë 09.09.2011 ka emërtimin Bachelor në Manaxhim Turizmi. Nga komunikimi me UV, u sqarua se UV lëshon diplomën me emërtimin Bachelor në Menaxhim Turizmi

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "IsmailQemali" Vlorë (UV), është një institucion publik i arsimit të lartë, i themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 105, datë 28.02.1994 me emërtim "Universiteti i Vlorës" dhe riorganizuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 822, datë 05.12.2007 dhe riemërtuar "Universiteti "IsmailQemali", Vlorë".

Universiteti zhvillon veprimtari në fushën e arsimit dhe shkencës në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr. 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".

UV është i organizuar në katër fakultete:

- | | |
|-----------------------------------|------------------------------------|
| (1) Fakulteti i Ekonomisë; | (3) Fakulteti i Shkencave Humane; |
| (2) Fakulteti i Shëndetit Publik; | (4) Fakulteti i Shkencave Teknike. |

Ky raport i vlerësimit të jashtëm analizon programin e studimit Bachelor në "Menaxhim Turizmi" licensuar me VKM Nr. 105, datë 28.02.1994 me afat studimi 4 vite dhe riorganizuar me Vendimin e Këshillit të Fakultetit, shkresë Nr. 121 Prot. Datë 22.07.2009 nga program Bachelor me kohëzgjatje 4 vite në 3 vite. Ky program ofrohet nga Departamenti i Biznesit, pranë Fakultetit të Ekonomisë (FE). FE është i organizuar në tre departamente:

- (1) Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit;
- (2) Departamenti i Biznesit;
- (3) Departamenti i Ekonomiksit.

Departamenti i Biznesit ofron studime në shtatë programe, tre të ciklit të parë bachelor dhe katër të ciklit të dytë si më poshtë:

- (1) Bachelor në Administrim Biznesi
- (2) Bachelor në Menaxhim Turizmi
- (3) Bachelor në Marketing
- (4) Master Profesional në Administrim Publik
- (5) Master Profesional Siper marrje në Turizem
- (6) Master Profesional në Marketing
- (7) Masteri Shkencave në Administrim Biznesi

Misioni i Departamentit të Biznesit është përgatitja, formimi dhe diplomimi i studentëve të aftë në fushën e biznesit, turizmit dhe marketingut në përputhje me trendet e tregut të punës në shërbim të zhvillimeve dinamike jo vetëm në kontekstin rajonal e kombëtar, por edhe në atë evropian e më gjerë (Rregullorja e Departamentit të Biznesit, fq.4).

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi” të ofruar nga Departamenti i Biznesit pranë UV, filloi me trajnimin, prezantimin si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të vlerësimit të brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

Vizita 2 ditore në UV e parashikuar për në datat 12-13 Mars 2020 nuk u realizua për shkak të Pandemisë.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, në dakortësi edhe më Universitetin e Vlorës realizoi takimet e përcaktuara në axhendën e vizitës në IALonline, në datën 14 Korrik 2020. Në këtë vizitë online, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) u takua nëpërmjet *meetingroom* të veçanta me: Dekanin e FE dhe Përgjegjës të Departamentit, Grupin e vetëvlerësimit, stafin akademik të programit të studimit, Drejtorinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional, sekretarinë mësimore, Drejtorinë e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore, Drejtorinë e Edukimit për Ciklin e I& II, intervistë me studentët. Vëzhgimi i mjedisvetë institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët etj., janë bërë nga eksperti E. Leskaj gjatë vizitës për vlerësimin e një programi tjetër të këtij departamenti në Mars 2020.

Gjatë takimeve u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit në fjalë, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ishin ngritur pyetje përkatëse.

Pas vizitës online në IAL, GVJ filloi punën për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe dhe të kërkuara në këtë Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin tek eksperti përkatës i ASCAL.

Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, ME. Renata Qatipi.

Shënim: Për shkak të Pandemisë së COVID-19, komunikimi me IAL Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë është bërë vetëm nëpërmjet sistemit AMS, bazuar në Urdhërin e MSHMS Nr. 132 datë 09.03.2020, Urdhërin e MASR Nr. 91 date 09.03.2020, Urdhërin e MSHMS Nr. 190 datë 19.03.2020.

Më datë 10.09.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 34/84 Prot., datë 10.09.2020 “*Njoftim për dërgimin e Draft-Raportit të Vlerësimit të Jashtëm*”, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

UV përcjell zyrtarisht përgjigjen për Draft-Raportin, me shkresë Nr. 1400/3 Prot., datë 17.09.2020 “*Përcjellje e komenteve mbi draft Raportin e vlerësimit të jashtëm të programit Bachelor në Menaxhim Turizmi*”.

Në këtë dokument institucioni ka disa komente për Draft Raportin e Vlerësimit të jashtëm. GVJ, pasi u njoh me komentet e UV sqaron si më poshtë:

1. Paragrafi në draft RVJ

Standardi I.3 Kriteri 1.

Lëndë të tilla si Strategjia e Turizmit dhe Ekonomia e Ambjentit nuk janë lëndë karakterizuese të programit për këtë cikël studimesh.

Komenti i Institucionit

Program i lëndëve “Strategji Turizmi” dhe “Ekonomi Ambjenti” fokusohet në njohjen në thellësi të turizmit në përputhje edhe me kontekstin në të cilin zhvillohet ai, si në planin institucional dhe të politikave, ashtu edhe në atë ambjental. Këto lëndë në këtë cikël studimesh synojnë aftësimin e specialistëve të ardhshëm të sektorit të turizmit, që përfshihen kryesisht në sektorin publik.

Argumentimi i GVJ

Lidhur me komentin e institucionit, GVJ thekson se lënda “Ekonomia e Ambjentit” nuk fokusohet në njohjen në thellësi të turizmit, por ajo studion efektet ekonomike të politikave mjedisore kombëtare dhe lokale, duke analizuar kostot dhe përfitimet e alternativave të ndryshme të përdorimit të mjedisit si dhe duke sugjeruar zgjidhje për problemet mjedisore të shkaktuara. Referuar syllabusit të lëndës “Strategjia e Turizmit”, GVJ vëren se kjo lëndë trajton politikën dhe planifikimin në turizëm, të cilat aplikohen pas një njohje të thellë të turizmit. Nisur nga sa u tha më lartë GVJ, mendon se këto dy lëndë më tepër i përkasin nivelit të dytë të studimeve dhe se në këtë nivel studimi, ku objektivi i të cilit është që t’i garantojë studentëve dije, për t’ju përgjigjur nevojave të tregut të punës, plani mësimor duhet të përmbajë lëndë që e aftësojnë studentin në njohjen, manaxhimin dhe shpërndarjen e shërbimeve turistike.

Për sa më sipër GVJ i qëndron rekomandimit të dhënë

2. Paragrafi në draft RVJ

Standardi I.3 Kriteri 1.

Nga shqyrtimi i syllabuseve vërehen ndryshime të emërimit të lëndëve në planin mësimor (Ndërmarrjet Turistike në syllabus Ndërmarrjet Turistike Pritëse, etj).

Komenti i Institucionit

Referuar programit mësimor të ciklit të parë të studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi” (Evidenca 2.3.1) emërtimi i lëndës është Ndërmarrjet Turistike. Emërtimi i lëndës Ndërmarrjet Turistike Pritëse është një lapsus i bërë në syllabusin e lëndës, duke qenë se në vitet e kaluara ka pasë këtë emër.

Argumentimi i GVJ

Bazuar në komentin e bërë nga institucioni, gjykojmë se konstatimi nga GVJ, i mospërputhjes të emërimit të lëndës në planin mësimor dhe në syllabus është i drejtë.

GVJ rekomandon saktësimin e emërimit të saj në syllabus.

3. Paragrafi në draft RVJ

Standardi I.3 Kriteri 1.

Në program ka bashkime lëndësh me objekt studimi të ndryshëm (“Ekonomia e Ambjentit dhe Turizmi i Qëndrueshëm” dhe lënda “Marketing Terriori dhe Turizëm Ndërkombëtar”)

Komenti i Institucionit

Bashkime të tilla lëndësh kanë patur si synim krijimin e programeve të lëndëve, të cilat trajtojnë argumenta plotësues të njeri-tjetrit. Kështu lënda “Ekonomia e Ambjentit dhe Turizmi i Qëndrueshëm”, ka në fokus trajtimin e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit mbi bazën e përdorimit eficient të burimeve mjedisore turistike, kurse lënda “Marketing Terriori dhe Turizëm

Ndërkombëtar” ka në fokus territorin me të gjithë elementet e tij në funksion të zhvillimit dhe marketimit të tregut turistik në kontekstin ndërkombëtar.

Argumentimi i GVJ

Referuar komentit të institucionit, GVJ gjykon se nuk është korrekt, komenti i bërë nga institucioni: ... “*lënda Ekonomia e Ambjentit dhe Turizmi i Qendrueshëm, ka në fokus trajtimin e zhvillimit të qendrueshëm të turizmit mbi bazën e përdorimit eficient të burimeve mjedisore turistike*” ..., pasi Turizmi i Qendrueshëm fokusohet në forma të zhvillimit turistik, që respektojnë dhe ruajnë për një kohë të gjatë burimet natyrore, kulturore dhe sociale, që kontribuojnë pozitivisht në zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e banorëve në ato zona. Ndërsa, lënda Ekonomia e Ambjentit, studion efektet ekonomike të politikave mjedisore kombëtare dhe lokale, duke analizuar kostot dhe përfitimet e alternativave të ndryshme të përdorimit të mjedisit si dhe duke sugjeruar zgjidhje për problemet mjedisore të shkaktuara.

Po kështu GVJ, gjykon se nuk qëndron argument i dhënë nga institucioni për bashkimin e dy lëndëve të tjera: Marketing Teritori dhe Turizëm Ndërkombëtar.....” *kurse lënda Marketing Teritori dhe Turizëm Ndërkombëtar ka në fokus territorin me të gjithë elementet e tij në funksion të zhvillimit dhe marketimit të tregut turistik në kontekstin ndërkombëtar.* Lënda Marketing Teritori studjon vendin me të gjitha burimet natyrore dhe kulturore për ta ofruar në treg si një vend turistik, ndërsa lënda Turizëm Ndërkombëtar ka në fokus zhvillimin e turizmit në nivel ndërkombëtar, analizon kërkesën, ofertën dhe flukset turistike në nivel global.

Nga sa më sipër GVJ thekson se lëndët Ekonomia e Ambjentit dhe Turizmi i Qendrueshëm si dhe lëndët Marketing Teritori dhe Turizëm Ndërkombëtar, nuk janë lëndë plotësuese të njera-tjetrës, por secila ka objektin e vet të studimit dhe mund të ketë një vend të veçantë në kurrikulën e programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”.

Për sa më sipër komenti nuk merret parasysh

4. Paragrafi në draft RVJ

Standardi I.3 Kriteri 1.

Në shumë lëndë të planit mësimor mungon literatura bazë në gjuhën shqipe.

Komenti i Institucionit

Për secilën prej lëndëve të planit mësimor të ciklit të parë të studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, ekziston një tekst apo cikël leksionesh në gjuhën shqipe, që përdoret si literaturë kryesore për lëndën. Por duke qenë se sektori turistik është një sektor mjaft dinamik, me zhvillime shumë të shpejta dhe statistika që duhen përditësuar, disa prej lëndëve karakterizuese të këtij programi pësojnë ndryshime të vazhdueshme, duke shtuar disa tema apo çështje, duke zgjeruar informacionet, duke përditësuar të dhënat dhe statistikat etj.

Argumentimi i GVJ

Nga shqyrtimi i syllabuseve (*Evidenca 2.3*) bashkangjitur me dokumentacionin dorëzuar nga institucioni në ASCAL, rezulton se syllabuset e lëndëve: Ekonomia e Ambjentit dhe Turizmi i Qendrueshëm; Marketing Teritori dhe Turizëm Ndërkombëtar, Ndërmarrjet Turistike, etj. Nuk përmbajnë literaturë në gjuhën shqipe.

Për sa më sipër komenti nuk merret parasysh

5. Paragrafi në draft RVJ

Standardi I.4 Kriteri 2 dhe 3.

Referuar RVB-së kodifikimi i programit studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, nuk është realizuar sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare dhe europiane.

Komenti i Institucionit

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë neni 86, “Kodifikimi i programeve të studimit”, paragrafi 1 kodifikimi i programeve të studimit realizohet nga ministria përgjegjëse. Në mungesë të VKM-së, udhëzimeve të MASR mbi kodifikimin e programeve të studimit, asnjë program studimi të ciklit të parë apo të dytë të ofruar nga fakulteti i Ekonomisë nuk është kodifikuar.

Argumentimi i GVJ

Bazuar në komentin e institucionit GVJ e heq këtë rekomandim

6. Paragrafi në draft RVJ

Standardi I.5 Kriteri 4.

Megjithatë GVJ gjykon që për programin në fjalë, duhet që marrëveshjet e bashkëpunimit me bizneset turistike të Rajonit të Vlorës të kenë si objektiv jo vetëm realizimin e praktikave profesionale, por edhe kryerjen e seminareve praktike për disa lëndë duke i shndëruar këto biznese në laboratore të mirëfillta për këto lëndë.

Komenti i Institucionit

Referuar ngarkesës në kredite të lëndëve të turizmit në këtë program studimi është bërë shpërndarja e tyre në leksione (në auditor dhe studim individual) dhe seminare (në auditor dhe studim individual), duke mos përfshirë në to ushtrime/laborator. Për këtë arsye studentët aftësohen praktikisht lidhur me teorinë e marrë gjatë zhvillimit të Lëndës së Praktikës profesionale në fund të këtij cikli studimi, kur ata janë kompletuar edhe me njohuritë teorike.

Argumentimi i GVJ

GVJ pasi lexoi komentin e institucionit sqaron se rekomandimi ka të bëjë me faktin se, institucioni që ofron këtë program studimi, i ndodhur në një zonë ku ushtrojnë veprimtari shumë biznese turistike, i ka të gjitha mundësitë që disa prej orëve të seminareve të parashikuara në planin mësimor të zhvillohen pranë këtyre bizneseve, gjë që do ti ndihmonte studentët për të konkretizuar konceptet teorike në praktikë duke finalizuar këtë me praktikën profesionale në fund të ciklit të studimeve.

GVJ mendon se kjo është lehtësisht e realizueshme dhe i qendron sygjërimit të dhënë

7. Paragrafi në draft RVJ

Standardi II.1 Kriteri 2 dhe 3.

Pavarësisht kësaj, GVJ është e mendimit që plani mësimor i programit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, për t’i shërbyer të kuptuarit të teorive dhe parimeve akademike të fushës, duhet të riorganizohet në funksion të konstatimeve të mësipërme (standardi 1.3, kriteri 1), duke vënë theksin më shumë tek modulet që lidhen me thellimin e njohurive në aspektin praktik të menaxhimit të aktiviteteve të turizmit.

Komenti i Institucionit

Për programin e ciklit të parë të studimit Bachelor në përputhje me emërtimin “Menaxhim Turizmi”, gjatë hartimit të planit mësimor, është synuar arritja e një balance ndërmjet ofrimit të një kadri sa më të plotë të njohurive teorike lidhur me menaxhimin dhe specifikat e tij për sektorin turistik dhe atyre aplikative që do ta aftësojnë studentin në aspektin praktik, duke qenë kështu sa më pranë përmbushjes së nevojave të tregut të punës që industria dikton. Për këtë qëllim janë pjesë e këtij programi studimi lëndë të tilla si Ndërmarrjet turisike, Sjellja e konsumatorit turist, Drejtim ndërmarrjesh turistike, Menaxhim destinacionesh, Organizim i udhëtimeve turistike, Pasuritë kulturore për operatorët turistik, Sistemet e informacionit në ekonomi.

Argumentimi i GVJ

GVJ referuar komentit të institucionit, thekson se përfshirja në planin mësimor të këtij programi studimi, të lëndëve të përmendura në koment, i pajis studentët me njohuri në disa drejtime të caktuara lidhur me menaxhimin e ndërmarrjeve të sektorit të turizmit. Por për të kompletuar sa më mirë njohuritë e studentëve dhe për ti aftësuar ata për të qenë sa më pranë përmbushjes së nevojave të tregut, bazuar edhe në argumentat e sjella lidhur me komentet 1, 2, 3, 4 dhe 6 të institucionit, GVJ gjykon se është i domosdoshëm rishikimi i planit mësimor për programin e studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”.

Për sa më sipër komenti nuk merret parasysh

8. Paragrafi në draft RVJ

Standardi II.2 Kriteri 3, 4 dhe 5.

Dekani i Fakultetit mban titullin akademik “Profesor i Asocuar”, Përgjegjësi i Departamentit të Marketingut gjithashtu ka gradën shkencore, “Profesor i Asocuar”.

Komenti i Institucionit

Dekani i Fakultetit mban titullin akademik “Profesor Doktor”, Përgjegjësi i Departamentit të Marketingut gjithashtu ka gradën shkencore, “Profesor i Asocuar”.

Argumentimi i GVJ

GVJ mbasi lexoi komentin e institucionit dhe shqyrtoi edhe një herë dokumentacionin konstaton se Dekani i Fakultetit të Biznesit pranë UV-së mban titullin akademik “Profesor Doktor” dhe Përgjegjësi i Departamentit të Marketingut pranë këtij fakulteti gjithashtu ka titullin akademik “Profesor i Asocuar”.

Për sa më sipër komenti merret parasysh

9. Paragrafi në draft RVJ

Standardi VI.4 Kriteri 3

Pavarësisht se NJSBCVI ka detyrimin institucional për ndjekjen e procedurave për sigurimin e Brendshëm të cilësisë, gjetjet dhe analizat janë të përgjithshme, ato nuk analizohen në nivel program studimi.

Komenti i Institucionit

Sikurse është sqaruar edhe në RVB të PS, (Standardi III.1 dhe Standardi VI.5, kriteri 2), për cdo program studimi realizohet analizë e hollësishme e rezultateteve të pyetësorit si dhe rekomandimet dhe gjetjet hartohen për cdo program studimi, më konkretisht për programin e studimit Bsc në

Argumenti i GVJ

GVJ referuar komentit të institucionit, dëshiron të theksojë se vlerëson punën e realizuar nga struktura e NJSBCVI deri tani në nivel institucional, në disa fakultete, dhe në shumë programe studimi në njësi bazë të ndryshme, vlerësim ky i vënë në dukje nga GVJ edhe gjatë takimit on-line me përfaqësues të NJSBCVI.

Në kuadër të një vlerësimi programor, kur institucioni ka një numër të lartë programesh, është praktikisht e pamundur nga ana e kësaj strukture realizimi i të gjithë proceseve, por njëkohësisht është e nevojshme rritja e rolit të njësisë kryesore dhe asaj bazë. Në këtë kuadër fokusi i rekomandimit të GVJ, konsiston një përfshirje më të madhe të njësisë kryesore si dhe të njësisë bazë në manaxhimin e proceseve për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe në specifikimin e tyre në nivel programor, konkretisht Bsc në MT, ndërkohë që NJSBCVI ndjek procesin në nivel institucional, sikurse ka bërë edhe tani, sepse edhe kriteri 3 këtë kërkon.

Për sa më sipër GVJ i qëndron të njëjtit rekomandim

10. GVJ konstaton në RVJ

Standardi VI.2 kriteri 4, 5

GVJ nuk hasi në një raport të vlerësues për zbatimin e masave të lëna as për vitin 2017-2018 dhe as për vitin 2018-2019. GVJ rekomandon që institucioni të ndjekë zbatimin e masave të propozuara nga njësitë kryesore dhe të miratuara nga senati, për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.

Komenti i Institucionit

Në përmbushje të kriterit dhe në lidhje me çfarë është shprehur GVJ, DSBCP komenton: “ Në mënyrë të vazhdueshme institucioni monitoron zbatimin e planit të masave. Strukturat e ngarkuara në Vendimin e Senatit përkatës të Planit të Masave për vitin akademik zbatojnë dhe raportojnë mbi përmbushjen e planit të masave duke i bërë pjesë integrale të raporteve të tyre të punës. Njëkohësisht NJSBCVI, ka përcjellë pranë autoriteve drejtuese të UV-së një raport të detajuar mbi realizimin e veprimtarive të parashikuara në këtë plan masash sëbashku me evidencat përkatëse. Ndërkohë që Plani i Masave për rezultatet e pyetësorëve të vitit akademik 2018-2019 është në proces diskutimi prej strukturave të përcaktuara në procedurë.”

Argumentimi i GVJ

GVJ mbasi lexoi komentet e institucionit dhe shqyrtoi edhe dy dokumentat e sjella prej institucionit sqaron se, në lidhje me rekomandimin e lënë GVJ i referohet raportit të zbatimit të masave në nivel programor, Në dokumentat e vendosura në dispozicion nga institucioni në këtë fazë, (dok. “ Raport 3 mujor I NJSBCVI dhe dok.2 “Informacion mbi zbatimin e planit të masave për 2017-2018), nuk identifikohen ndërhyrje si rezultat i problematikave të dala nga vlerësimi i brendshëm në nivel programor, për PS beh.në MT

Për sa më sipër komenti nuk merret parasysh

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Menaxhim Turizmi”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Programi i studimit Bachelor “Menaxhim Turizmi” nuk bie ndesh me interesat kombëtare, ai synon të ndihmojë në ruajtjen e vlerave dhe interesave kombëtare duke kontribuar në një zhvillim të qendrueshëm të ekonomisë, kryesisht të industrisë turistike si një nga sektorët më proritare të zhvillimit ekonomik në vendin tonë.</p> <p>Ky program studimi zhvillon një sërë aftësish praktike dhe menaxheriale me qëllim menaxhimin e shërbimeve në sektorë të ndryshëm të industrisë turistike.</p> <p>Programi i studimit synon nxitjen dhe respektimin e vlerave kombëtare, në përputhje të plotë edhe me misionin, të shprehur në strategjinë e zhvillimit të institucionit.</p> <p><i>Ligji i Arsimit të Lartë, nr.80/2015 Evidenca A: Statuti i UV Evidenca B: Plani Strategjik i UV-së 2018 – 2024 Strategjia Kombëtare për zhvillimin e qendrueshëm të turizmit</i></p>
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, ofruar nga Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, synon ruajtjen dhe konsolidimin i vlerave akademike.</p> <p>Ky program studimi mbështetet në misionin kryesor të UV-së, për të përcjellë një edukim cilësor, me anë të gërshetimit të një studimi teorik të vlefshëm me praktikën, në funksion të nevojave dhe të dijeve të shoqërisë shqiptare.</p> <p>Programi në të gjithë elementët e tij, pasqyron kujdesin dhe kontributin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore, akademike dhe shkencore të vendit.</p>
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, është në funksion të përmbushjes së misionit dhe objektivave të institucionit. Në të janë përcaktuar qartë objektivat për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë përmes njohurive bazë ekonomike që marrin në përfundim të studimeve Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, në UV.</p> <p><i>Evidenca A: Statuti i UV Evidenca B: Plani Strategjik i UV-së 2018 – 2024 Evidenca 1.2: Plani Strategjik i Departamentit të Biznesit, UV 2018 – 2024</i></p>
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose	<p>Programi i studimit është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, të cilat lidhen me fushën e studimit, në përputhje me përparësitë e zhvillimit të vendit.</p> <p>Sot turizmi vlerësohet si një nga sektorët më kontribues në zhvillimin</p>

kombëtar.	<p>ekonomik të vendit. Efektet pozitive të tij shihen si në rritjen e punësimit ashtu edhe në rritjen e të ardhurave reale. Në këtë kuader programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, zhvillon një sërë aftësish, praktike dhe menaxheriale me qëllim menaxhimin e shërbimeve në sektorë të ndryshëm të industrisë turistike, aftësi të cilat do të nxisin zhvillimin ekonomik lokal e kombëtar.</p> <p><i>Ligji i Arsimit të Lartë, nr.80/2015 Strategjia Kombëtare për zhvillimin e qendrueshëm të turizmit</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, hartohet dhe ofrohet nga institucioni në përputhje me strategjinë e zhvillimit të tij. Kjo shihet qartë në dokumentat strategjike të institucionit por edhe në dokumentat bazë të programit të studimit në shqyrtim. GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, është konceptuar në harmoni me strategjitë e institucionit. Ai është konform objektivave strategjike për organizimin dhe zhvillimin e këtij programi në përputhje me Statutin e Institucionit.</p> <p><i>Evidenca A: Statuti i UV Evidenca B: Plani Strategjik i UV-së 2018 – 2024 Evidenca 1.2: Plani Strategjik i Departamentit të Biznesit, UV 2018 – 2024</i></p>
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstron se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentave strategjike të UV-së, (Statuti, dhe Rregullorja e Fakultetit) si dhe nga vizita online, e zhvilluar në institucion, GVJ arrin në përfundim se: organizimi i programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi” është bazuar në dokumenta strategjike që orientojnë misionin dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit.</p> <p><i>Evidenca A: Statuti i UV Evidenca C: Rregullore e UV-së</i></p>
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	<p>Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, është hartuar në përputhje të plotë me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe tendencat globale të zhvillimit.</p> <p>Megjithatë GVJ gjykon se, duhet të bëjë më shumë përpjekje për të integruar në programin e studimit, module të cilat pajisin studentët me kompetenca që i përgjigjen më mirë nevojave lokale, praktikisht të biznesit në qytetin e Vlorës, por edhe me gjerë.</p> <p><i>GVJ sugjeron që, programi i studimit, në kushtet aktuale të zhvillimit të turizmit si dhe për rëndësinë që ka ai për zhvillimin ekonomik të vendit tonë, ka nevojë për integrimin në të lëndëve që lidhen drejtpërsëdrejti me</i></p>

	menaxhimin e shërbimeve turistike si dhe lidhjen e teorisë me praktikën. <i>Evidenca B: Plani Strategjik i Departamentit të Biznesit, UV 2018 – 2024 Evidenca 1.3: Rregullore e Programit të ciklit të parë të studimit “Menaxhim Turizmi”. VKM nr. 41, datë 28.01.2018</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.3

Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Programi i studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në “Menaxhim Turizmi” i ofruar nga Departamenti i Biznesit pranë Fakultetit të Ekonomisë së Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, përcakton nevojën e tregut të punës në sektorët ndryshëm të fushës së turizmit. Ky program studimi synon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të pajisë studentët me njohuri mbi proceset bazë të planifikimit, organizimit, koordinimit dhe kontrollit në vendin e punës; - të aftësojë studentët në zotërimin e njohurive të profilit ekonomik të programit (financë, statistikë, ekonomiks etj.); - të zhvillojë aftësitë në fushën e marketingut; - të aftësojë studentët për të aplikuar zgjidhje praktike lidhur me problemet komplekse të bizneseve turistike. <p>Nga shqyrtimi i programit, GVJ gjykon që përvetësimi i aftësive në funksion të realizimit të këtyre objektivave, shtron nevojën për disa ndryshime në planin mësimor. Kështu:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lëndë të tilla si Strategjia e Turizmit dhe Ekonomia e Ambjentit nuk janë lëndë karakterizuese të programit për këtë cikël studimesh. - Nga shqyrtimi i syllabuseve vërehen ndryshime të emërtimit të lëndëve në planin mësimor (Ndërmarrjet Turistike në <i>syllabus Ndërmarrjet Turistike Pritëse</i>, etj). - Në program ka bashkime lëndësh me objekt studimi të ndryshëm (Ekonomia e Ambjentit dhe Turizmi i Qëndrueshëm dhe lënda Marketing Teritori dhe Turizëm Ndërkombëtar) - Në shumë lëndë të planit mësimor mungon literatura bazë në gjuhën shqipe.
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë</p>	<p>Departamenti i Biznesit pranë Fakultetit të Ekonomisë të UV-së, përgjegjës për programin e studimit, ka bërë përpjekje për të analizuar nevojat e tregut të punës, për të përshtatur programin e studimit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, shihen përpjekjet për këto studime në kuadër të disa projekteve si ai lidhur me “Impaktin në punësim i kurrikulave të studimeve të nivelit të parë të studimeve pranë FE të UV-së”, 2011-2012, financuar</p>

<p>periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>nga Ministria e Arësimit si dhe projekte të tjera rritjen e mundësive për punësimin e të rinjve, gjurmimin e studentëve të punësuar etj.</p> <p><i>Evidenca J: Raporti Vjetor i UV-së për vitin 2018-2019</i></p>			
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet, garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i përmbajtjes së programit të studimit, GVJ konstaton se objektivat formuese dhe struktura e programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, duhet të orientohet më mirë nga nevojat e tregut të punës. Ashtu si u përmend dhe më sipër GVJ gjykon që për përmbushjen e objektivave të këtij programi studimi nevojitet ristrukturimi i programit</p> <p><i>Aneks 1: Tabela 9, “Plani mësimor, sipas veprimtarive formuese”</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi I.4 Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, ofrohet nga Departamenti i Biznesit në Fakultetin e Ekonomisë në UV. Ky program fillimisht që prej vitit 1994 ofrohej si diplome katër vjeçare nga Departamenti i Biznesit pranë Fakultetit të Tregëtisë sot Fakultetit i Ekonomisë. Kështu që, stafi akademik i aktivizuar në program, me eksperiencë relativisht të gjatë akademike, është në përputhje me fushën e programit të studimit.</p> <p>Referuar dokumentave që shoqërojnë RVB-në, stafi akademik i angazhuar në program për vitin akademik 2019-2020 përbëhet nga 28 pedagogë nga ku 27 pedagogë efektivë (PAE), nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 Prof. Dr, - 6 Prof. Assoc. - 14 Dr - 6 Msc, <p>dhe 1 pedagog me kontratë (PAK)</p> <p>Mbulimi i programit në përqindje është 27 PAE/1 PAK, 96% PAE.</p>

	<p>Në vitin 2018-2019 janë angazhuar gjithsej 30 pedagogë nga ku 28 pedagogë efektivë (PAE), nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 Prof. Dr, - 7 Prof. Assoc. - 10 Dr, - 10 Msc, <p>dhe 2 pedagogë me kontratë (PAK).</p> <p>Mbulimi i programit në përqindje është 28 PAE / 2 PAK, 93% PAE.</p> <p>Në vitin 2017-2018 janë angazhuar gjithsej 25 pedagogë nga ku 24 pedagogë efektivë (PAE), nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 4 Prof. Assoc - 12 Dr, - 8 Msc, <p>dhe 1 pedagog me kontratë (PAK).</p> <p>Mbulimi i programit në përqindje është 24 PAE/1 PAK, 96% PAE.</p> <p><i>Aneks 1: Tabelat 6.1-6.4 "Cilësia estafit akademik për programin e studimit Bachelor në "Menaxhim Turizmi".</i></p>			
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në "Menaxhim Turizmi", është program studimi i ciklit të parë të studimit, i cili organizohet me 180 ETC dhe kohëzgjatje 3 vite akademike.</p> <p>Programi ofrohet nga Departamenti i Biznesit pranë Fakultetit të Ekonomisë në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të tyre.</p> <p>UV siguron zbatimin në kushte të përshtatshme të programeve të studimit që ofron nëpërmjet organizimit të tyre në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë.</p> <p>Referuar RVB-së kodifikimi i programit studimit Bachelor në "Menaxhim Turizmi", nuk është realizuar sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare dhe evropiane.</p> <p><i>Ligji i Arsimit të Lartë, nr.80/2015 Evidenca B: Plani Strategjik i UV-së 2018 – 2024</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Nuk</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet</p>

standardit	përmbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Referuar RVB-së dhe shqyrtimit të dokumentave shoqëruese, GVJ konstaton se ka një ndarje të detyrave dhe përgjegjësiwe mes strukturave të institucionit, ku pesha kryesore për programin e studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, mbulohet nga njësia bazë përgjegjëse, Departamenti i Biznesit, pranë Fakultetit Ekonomik në UV.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, ka në përbërje të tij edhe module, të cilat ofrohen nga departamente të tjera brenda fakultetit si Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit dhe ai i Ekonomiksit. Gjithashtu disa lëndë ofrohen nga departamente pranë fakulteteve të tjera të UV-së si: Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë, Departamenti i Matematikës dhe nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike.</p> <p>Gjithashtu në nivel institucional ushtojnë aktivitetin edhe disa struktura ndihmës akademike të tilla si Drejtoria e Komunikimit dhe e Burimeve Njerëzore, Qendra e Studimeve Ndërdisciplinore e Zhvillimit Rajonal, Drejtoria e Shërbimit të Brendshëm të Cilësisë, Drejtoria e Edukimit për Ciklin e Parë dhe të Dytë, Sektori I Kërkimit Shkencor dhe promovimit Akademik etj.</p> <p><i>Evidenca A: Statuti i UV Evidenca I:Raporti Vjetor i UV-së për vitin 2017-2018 Evidenca J:Raporti Vjetor i UV-së për vitin 2018-2019</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Në nivel institucional UV merr pjesë në një sërë projektsh bashkëpunimi në kuadër të Erasmus+ dhe Mevlana. Qëllimi i bashkëpunimit është për implementimin e projekteve të përbashkëta kërkimore shkencore, për shkëmbim të stafit akademik, atij administrativ dhe të studentëve</p> <p>Një nga objektivat kryesore të UV-së, është ndërkombëtarizimi i universitetit dhe ndërkombëtarizimi i programeve të studimit me qëllim rritjen e cilësisë si në drejtim të mësimdhënies ashtu edhe atë të mësimnxënies. Ky objektivi shprehet në numër të rritur të mobiliteteve si me universitetet në rajonin e Ballkanit ashtu edhe me ato Evropiane.</p> <p>Sot UVka marrëveshje e bashkëpunimi me një sërë universitete të shume shteteve në Europë si në Itali, Belgjike, Estoni, Bullgari, Greqi, Finlandë, Norvegji, Spanjë, Sërbi, Rumani dhe Turqi.</p> <p><i>Evidenca B: Plani Strategjik i UV-së 2018 – 2024 Evidenca J:Raporti Vjetor i UV-së për vitin 2018-2019</i></p>

<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit por edhe nga takimet gjatë vizitës online në IAL, vihet re një numër i konsiderueshëm marrëveshjesh në nivel universiteti, në nivel fakulteti dhe në nivel departamenti. Institucioni ka vënë në dispozicion një listë biznesesh e cila mund të shërbejë si një databazë për studentët për zhvillimin e praktikës.</p> <p>Departamenti i Biznesit si njesi përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimeve në funksion të realizimit të programit.</p> <p>Megjithatë GVJ gjykon që për programin në fjalë, duhet që marrëveshjet e bashkëpunimit me bizneset turistike të Rajonit të Vlorës të kenë si objektivi jo vetëm realizimin e praktikave profesionale, por edhe kryerjen e seminareve praktike për disa lëndë duke i shndëruar këto biznese në laboratore të mirëfillta për këto lëndë.</p> <p><i>Evidenca 1.5: Raporti Vjetor i DB për vitin 2018-2019</i> <i>Evidenca 1.3: Rregullore e Programit të ciklit të parë të studimit “Menaxhim Turizmi”.</i> <i>Evidenca C: Rregullore e UV-së Aneks 1: Tabelat 5 “Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese për praktikat profesionale në profilin Bachelor në “Menaxhim Turizmi”.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Institucioni nuk ofron trajnime profesionale për këtë program studimi. Nga shqyrtimi i RVB-së dhe nga diskutimet e kryera gjatë vizitës online, GVJ konstaton se me qëllim realizimin e objektivave të procesit mësimor të programit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, institucioni po bën përpjekje nëpërmjet Qendrës Studimore Ndërdisciplinore të Zhvillimit Rajonal për krijimin e mundësive për trajnimin e studentëve në pozicione të ndryshme të sektorit të turizmit si agjent udhëtues, reception, kamarier etj.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<p>Standardi II.1 Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi” pranë</p>

<p>module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Departamentit të Biznesit në Fakultetin Ekonomik në UV, referuar dokumentacionit, rezulton të jetë i organizuar, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Lëndët në program janë karakterizuar sipas veprimtarive formuese dhe kanë të përcaktuar ngarkesën dhe numrin e krediteve.</p> <p>Nga evidencat rezulton se për tre vitet e fundit, 2017-2018, 2018-2019 dhe 2019-2020, programi përmban 28 lëndë, praktikën profesionale si dhe punimin e tezës së diplomës.</p> <p>Në këto tre vite plani mësimor është plotësuar me module si p.sh. lëndët <i>Drejtimi Marketing, Sjellje Organizative, Sjellja e Konsumatorit Turist</i> janë shtuar në vitet akademike 2018-2019 dhe 2019-2020. Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi” realizohet në 3 vite, ndarë në 6 semestra, gjatë të cilit studenti fiton 180 kredite dhe realizon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1725 orë në auditor; - 150 orë Praktika profesionale; - 2475 orë punë individuale; - 150 orë Mikroteza; <p><i>Ligji i Arsimit të Lartë, nr.80/2015VKM nr. 41, datë 28.01.2018 Aneks 1: Tabela 9, “Plani mësimor, sipas veprimtarive formuese”</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p> <p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi” është një program studimi në vazhdimësi që prej më se 25 vjetësh, që synon arsimimin dhe kualifikimin profesional të studentëve në fushën e turizmit.</p> <p>Gjykimi i ekspertëve në lidhje me planin mësimor të programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, është që ky plan mësimor ka në përbërje të tij, lëndë që i ofrojnë studentit njohuri teorike dhe aplikative, duke i shërbyer përgatitjes së profesionistëve në përshtatje me tregun e punës.</p> <p>GVJ konkludon se nëpërmjet realizimit të misionit të tij, programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, synon formimin e shprehive dhe aftësive në disa drejtime si turizëm, menaxhim, financë, ekonomi, menaxhim burimesh njerëzore etj.</p> <p>Referuar përmbajtjes së programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, syllabuseve të lëndëve dhe takimit (online) që GVJ pati me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë përgjegjëse për këtë program studimi, rezulton se ky program studimi, krijon mundësinë që studentët të marrin njohuri të thelluara në fushën e menaxhimit të shërbimeve në sektorë të ndryshëm të industrisë turistike.</p> <p>Pavarësisht kësaj, GVJ është e mendimit që plani mësimor i programit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, për t’i shërbyer të kuptuarit të teorive dhe parimeve akademike të fushës, duhet të riorganizohet në funksion të konstatimeve të mësipërme (standardi 1.3, kriteri 1), duke vënë theksin më shumë tek modulet që lidhen me thellimin e</p>

	njohurive në aspektin praktik të menaxhimit të aktiviteteve të turizmit.
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>GVJ mbështetur në planin mësimor të programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi” dhe takimeve me studentë të programit si dhe me stafin akademik të përfshirë në program, është i mendimit se programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, nëpërmjet lëndëve që përmban, syllabuseve të tyre, si dhe mënyrës si organizohen lëndët, synon të jetë i orientuar drejt zhvillimit të njohurive, aftësive dhe kompetencave të lidhura me fushën e turizmit.</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p> <p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Referuar evidencave si dhe takimit me drejtuesin e njesisë kryesore dhe asaj bazë, rezultojnë se elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, bazohen mbi përcaktimet e VKM 41, datë 24.01.2018 dhe analizohen si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, rezultojnë të ketë 28 lëndë, praktikën mësimore dhe punimin e diplomës. Lëndët zhvillohen në 6 semestra me 180 kredite, ku punimi i diplomës dhe praktika profesionale përmbajnë secila nga 6 kredite. Në planin mësimor gjenden të gjitha ndarjet sipas veprimtareve formuese nga A-E. GVJ konstaton ndarjen e veprimtarive formuese në planin mësimor si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> - Lëndët bazë (kategoria A) me 32 kredite, kanë 18% të krediteve; - Lëndët karakterizuese (kategoria B) me 99 kredite, kanë 55% të krediteve; - Lëndët integruese (kategoria C) me 25 kredite kanë 14% të krediteve; - Lëndët plotësuese (kategoria D) me 18 kredite kanë 10% të krediteve; - Detyrimet përmbyllëse (kategoria E) me 6 kredite ka 3% të krediteve; <p>GVJ konstaton se ndarja sipas veprimtarive formuese është në përputhje të plotë me VKM nr 41, datë 24.01.2018.</p> <p>GVJ konstaton se syllabuset e lëndëve janë organizuar duke pasur në përmbajtje, objektivat, temat, literaturën bazë dhe ndihmëse, emrin e Titullarit, numrin e krediteve si dhe ngarkesën leksion/seminar.</p> <p>Hartimi i syllabusit është bazuar në modelin e përcaktuar në VKM nr. 41, Dt.24.01.2018. Për shumë lëndë të përfshira në program mungon literatura bazë në gjuhën shqipe, ndërsa literatura në gjuhë të huaj është e para 10 viteve.</p> <p>Në përfundim të studimeve studentët pajisen me diplomë e cila shoqërohet edhe me suplementin përkatës. GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionin e sjellë nga institucioni, konstatoi se këto dokumenta, kanë elementët e duhur në përbërje dhe janë në përputhje me emërtimin</p>

	e programit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Njësia kryesore (Fakulteti i Ekonomisë) si dhe ajo bazë (Departamenti i Biznesit) përgjegjëse për programin e studimit përmbushin detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. Njësia bazë, Departamenti i Biznesit zhvillon të gjithë aktivitetin në përputhje me legjislacionin në fuqi në përmbushje të gjithë standardeve të cilësisë për mësimdhënie dhe procesin e kërkimit shkencor. Grupi i vlerësimit të brëndshëm përbëhet nga anëtarë të personelit akademik efektiv të departamentit dhe një përfaqësues i studentëve të këtij programi studimi, krijuar që nga viti 1994 miratuar me VKM 105, date 28.02.1994.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga Ligji i Arsimit të lartë Nr. 80/2015 është përcaktuar emërimin e koordinorit të programit. Nga informacioni i siguruar nga RVB, rezulton se koordinatori i programit, gjithashtu është përgjegjës edhe për koordinimin e marrëdhënieve të departamentit me studentët.</p> <p>Koordinatori i programit bashku me përgjegjësinë e Departamentit të Biznesit dhe përgjegjësit e grupeve mësimore, kryejnë promovimin e programeve të studimit që ofron njësia bazë, informon, orienton dhe këshillon studentët për veprimtarinë mësimore dhe aktivitetet e tjera të organizuara nga njësia bazë.</p> <p><i>Ligji i Arsimit të Lartë, nr.80/2015 Evidenca 2.2: Rregullore e Departamentit të Biznesit</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p> <p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë, krijuar në vitin 1994, me VKM 105, date 28.02.1994 është njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”. Fakulteti i Ekonomisë pranë UV-së, vepron kornizave ligjore, në respekt të ligjit të Arsimit të Lartë në fuqi, Statutit dhe Rregullores së UV-së. Fakulteti aktualisht përbëhet nga 3 njësi bazë: Departamenti i Biznesit, Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit, Departamenti i Ekonomisë si dhe njësi të tjera ndihmëse mësimore dhe shkencore.</p> <p>Departamenti i Biznesit ofron programin e ciklit të parë të studimit Bachelor “Menaxhim Turizmi” dhe programe të ciklit të dytë të studimeve Master Profesional dhe Master Shkencor. Stuktura, detyrat dhe përgjegjësitë e njësisë kryesore dhe asaj bazë, që është përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, janë të</p>

<p>studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>përcaktuara në statut dhe në Rregulloren e Fakultetit, të cilat janë në përputhje me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë.</p> <p>Dekani i Fakultetit mban titullin akademik “Profesor Doktor” dhe Përgjegjësi i Departamentit të Marketingut pranë këtij fakulteti gjithashtu ka titullin akademik “Profesor i Asocuar”..</p> <p>Departamenti i Biznesit, si njësi bazë, përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi” është strukturuar sipas kërkesave ligjore dhe aktualisht ka 16 anëtarë personel akademik me kohë të plotënga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 6Prof.Assoc.Dr, - 9Dr. - 1Msc (në proces doktrate). <p>Gjithashtu pranë DB janë të angazhuar edhe 2 anëtarë personel akademik me kontratë.</p> <p>Përsa më sipër, GVJ konstaton se njësi kryesore dhe njësi bazë, plotësojnë detyrimet ligjore për nivelin e kualifikimit të personelit akademik. GVJ referuar dokumentave të mëposhtëm ku institucioni deklaron të dhënat për stafin akademik efektiv për vitet, 2019-2020, konstaton se numri i stafit efektiv, në njësinë bazë ka mbi 7 anëtarë, duke plotësuar kriterin ligjor minimal 7 anëtarë - staf efektiv, për çdo njësi bazë.</p> <p><i>Aneks 1. Tabela 1.1, 1.2, 1.3, 1.4 Departamenti i Biznesit Aneks 1. Tabela 2.1, 2.2, 2.3, 2.4 Departamenti i Biznesit Evidenca A: Statuti i UV Evidenca C: Rregullore e UV-së Ligji i Arsimit të Lartë, nr.80/2015</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi II.3

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësi kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Nga dokumentacioni i depozituar në sistemin AMS, GVJ konstatoi se, njësi kryesore dhe ajo bazë, për organizimin e programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, disponojnë informacionet e nevojshme si: rregullorja e programit, plani mësimor, shpërndarja e lëndëve sipas pedagogëve etj. Ajo propozon strukturën dhe ndryshimet në planin mësimor, kurrikulën dhe stafin e përfshirë. Përgjegjësi i Departamentit është titullari që i propozon drejtuesve rishikimin e programit nëse është i nevojshëm.</p> <p><i>VKM nr. 41, datë 28.01.2018 Evidenca 1.3: Rregullore e Programit të ciklit të parë të studimit “Menaxhim Turizmi”. Evidenca 2.2: Rregullore e DB-s</i></p>

<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p> <p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>GVJ konstaton se, në programin e studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, ndarja sipas veprimtarive formuese e lëndëve është në përputhje të plotë me VKM nr 41.</p> <p>Programi i studimit, për çdo lëndë ka të përcaktuar kategorinë të cilës i përket si dhe numrin e krediteve sipas sistemit ECTS, vitin dhe semestrin kur zhvillohet lënda. Nga shqyrtimi i tabelës 9, rezulton se lëndët kanë 7, 6, 5 dhe 4 kredite, ndërsa praktika profesionale dhembrojtja e diplomës kanë nga 6 kredite. Programi zhvillohet në 6 semestra. Kohëzgjatja e programit është 3 vjet me nga 60 kredite në vit dhe 180 kredite në total.</p> <p>GVJ konstaton se programimësimor Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, përmban informacion të plotë për ndarjen e çdo lënde në komponentët leksion/seminar, orët në auditor/jashtë auditorit, dhe kreditet për çdo aktivitet.</p> <p>Referuar <i>Rregullores së Programit të ciklit të parë të studimit “Menaxhim Turizmi”</i>, rezulton se janë të parashikuara dhe të përcaktuara klauzolat për skemën e vlerësimit të studentëve si dhe për detyrimin e studentëve për nivelin e frekuentimit të programit. Kontrolli i dijes për studentët e programit të ciklit të parë të studimit “Menaxhim Turizmi”, realizohet nëpërmjet vlerësimit gjithë semestral. Konkretisht, vlerësimi i dijeve gjatë vitit bëhet sipas rregullit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Provimi i pjesëshëm 30 % - Vlerësimi vjetor 10 % - Provimi final 60 % <p>Në total studenti mund të përfitojë 100 pikë të mundshme.</p> <p>Për frekuentimin e studentëve IAL ka vendosur:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për leksionet dhe seminarët detyrimi është në masën 75 % <p>Vlerësimi përfundimtar bëhet mbi bazën e pikëve të grumbulluara dhe përqindjeve përkatëse. Të gjitha provimet zhvillohen me shkrim. GVJ është e mendimit se këto skema vlerësimi krijojnë mundësi të nxitjes dhe aktivizimit të studentëve gjatë gjithë semestrit, duke përdorur forma alternative vlerësimi dhe duke i shërbyer formësimit dhe përvetësimit të dijeve të qëndrueshme.</p> <p><i>VKM nr. 41, datë 28.01.2018 Evidenca 1.3: Rregullore e Programit të ciklit të parë të studimit “Menaxhim Turizmi” Aneks 1: Tabela 10, “Plani mësimor, Bachelor në “Menaxhim Turizmi” Evidenca 2.3: Syllabusët e programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi” Evidenca 2.3.1: Planet mësimore 2019-2020</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit si edhe në dokumentet e tjera rregullatore të UV-së, përcaktohen kriteret e pranimit, transferimit dhe të ekuivalentimit të studimeve si edhe proceset që lidhen me to.</p> <p>Këto kritere janë përcaktuar në zbatim të ligjit të Arsimit të lartë dhe udhëzimeve të MASR. Kandidatët që aplikojnë për të ndjekur studimet në ciklin e parë në UV, pranohen me notë mesatare mbi 6,5. Referuar Rregullores së UV-së të drejtën për transferim të studimeve e kanë</p>

	<p>studentët që kanë siguruar të paktë 30 kredite. Nota mesatare e lëndëve të ekuivalentuara vlerësohet me 0-25 pikë në intervalin e notës 5-10.</p> <p><i>Evidenca 1.3: Rregullore e Programit të ciklit të parë të studimit "Menaxhim Turizmi". Evidenca C: Rregullore e UV-së Evidenca 2.4: Kriteret e pranimit të studentëve në programin e studimit Bachelor "Menaxhim Turizmi" Evidenca 2.5: Kuotat e pranimit të studentëve në programin e studimit Bachelor "Menaxhim Turizmi" Evidenca 2.6: Kriteret për transferim studimesh për ciklin e parë dhe të dytë të studimit Evidenca 2.7: Kapacitetet akademike dhe fizike të FEEvidenca 2.8: Procedura e pranimit të studentëve në programin e studimit Bachelor "Menaxhim Turizmi" Evidenca 2.9: Procedura e transferimit të studentëve të ciklit të parë të studimit Bachelor "Menaxhim Turizmi"</i></p>			
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit shoqërohet me syllabuset e çdo lënde. Nga shqyrtimi i syllabuseve GVJ, konstaton se në këto syllabuse ka informacion për objektivat, për literaturën, për format e organizimit, mënyrën e vlerësimit etj.</p> <p>GVJ konstaton se Syllabuset e lëndëve janë organizuar duke pasur në përmbajtje, objektivat, temat, literaturën bazë dhe ndihmëse, emrin e titullarit, numrin e krediteve si dhe ngarkesën leksion seminar. Jo të gjitha syllabuset e kanë titullarin me gradën Prof. ose Prof.As.</p> <p>Modeli që përdoret për hartimin e tyre, është bazuar në modelin e përcaktuar në VKM nr. 41, Dt.24.01.2018. Për disa lëndë mungon literatura bazë në shqip, ndërsa literatura e huaj është e para 10 viteve.</p> <p><i>VKM nr. 41, datë 28.01.2018 Evidenca 1.3: Rregullore e Programit të ciklit të parë të studimit "Menaxhim Turizmi"</i></p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Nga informacioni i siguruar gjatë takimit me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në "Menaxhim Turizmi", rezulton se programi i studimit për tre vitet e fundit ka pësuar ndryshime. Këto ndryshime janë bërë në funksion të nevojave të tregut dhe sipas udhëzimeve të MASR.</p> <p><i>Evidenca 2.10: Procedurat e riorganizimit të programit të studimit Bachelor në "Menaxhim Turizmi"</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore

Referuar programit të studimit Bachelor në "Menaxhim Turizmi", GVJ konstaton se program është strukturuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe përmban:

<p>e nënligjore në fuqi.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - 180 Kredite të ndara në 3 vite akademike me 60 kredite secili; - Orë total 4500, ku, 1875 orë në auditor dhe 2625 orë jashtë auditorit; - Për çdo lëndë të përfshirë në programin mësimor është përcaktuar ngarkesa e orëve në auditor dhe jashtë auditorit; - Çdo vit akademit perbëhet nga dy semestra me 15 javë mësim dhe 3-4 javë provime secila; - Në vitin e parë zhvillohen 1500, ku, 630 orë në auditor dhe 870 orë jashtë auditorit; - Në vitin e dytë zhvillohen 1500, ku, 615 orë në auditor dhe 885 orë jashtë auditorit; - Në vitin e tretë zhvillohen 1500 orë, ku, 630 orë në auditor dhe 870 orë jashtë auditorit; <p>GVJ është e mendimit se ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p><i>Evidenca 2.10: Procedurat e riorganizimit të programit të studimit Bachelor në "Menaxhim Turizmi" Evidenca 1.3: Rregullore e Programit të ciklit të parë të studimit "Menaxhim Turizmi" Aneks 1: Tabela 10, "Plani mësimor, Bachelor në "Menaxhim Turizmi" Evidenca 2.11: Kalendari akademik për vitin 2019-2020</i></p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>GVJ është e mendimit se programi studimit Bachelor në "Menaxhim Turizmi", ka përputhshmëri, midis emërtimit të tij dhe lëndëve që përmban, të cilat do të mundësojnë studentëve që vazhdojnë këtë program studimi, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme si dhe për punësimi. Shpërndarja e lëndëve, mundëson thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve. <i>Megjithatë GVJ mendon që programi mund të pasurohet me lëndë të karakterit praktik që lidhin me shërbime specifike të fushës së turizmit.</i></p> <p><i>Aneks 1: Tabela 9, "Plani mësimor, sipas veprimtarive formuese"</i></p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimin profesional.</p> <p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Sipas RVB-së, në programin e studimit Bachelor në "Menaxhim Turizmi", shpërndarja e lëndëve në vite dhe semestra, vlerësimi në kredite dhe orë mësimore bën të mundur arritjen e objektivave kryesore formuese të programit.</p> <p>GVJ është e mendimit, se edhe pse objektivat e programit nuk dalin shumë të qarta nga materialet e shqyrtuara, disa ndryshime në grupin e lëndëve karakterizuese që do të bënin përmbushjen sa më mire të qëllimit të këtij programi studimi.</p> <p>Kështu GVJ mendon se përgjegjësi për këtë program studimi duhet të reflektojë ndryshimet në lëndët "Marketing Territori dhe Turizëm Ndërkombëtar", "Ekonomia e Ambjentit dhe Turizëm i Qendrueshëm", të zëvendësojë lëndën "Strategjia e Turizmit" me lëndë që do ta aftësonin studentin më shumë në menaxhimin e shërbimeve të ndryshme turistike dhe do të rrisnin më shumë përputhshmërinë e programit me emërtimin e</p>

	<p>diplomës që ai lëshon.</p> <p>Përsa i përket ngarkesës në kredite dhe raportit leksion/seminar dhe konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1185 orë leksione - 540 orë seminare - 150 orë praktika në terren <p>Pra raporti teori praktike: 1185/690, ose 1.7 me 1. GVJ gjykon se programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, është i përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p><i>Aneks 1: Tabela 9, “Plani mësimor, sipas veprimtarive formuese“ Aneks 1: Tabela 10, “Plani mësimor, Bachelor në “Menaxhim Turizmi” Aneks 1: Tabela 13, “Ngarkesa totale në auditor e studentëve për format e mësimdhënies në programin e studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, Evidenca 2.12: Përcjellje e riorganizimit të programeve të studimit në pesë vitet e fundit</i></p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Referuar dokumentaveraporti leksion/seminar mundëson përfundimin e njohurive teorike dhe aplikimin e tyre nga studentët. Nga shqyrtimi isyllabuseve të lëndëve si dhe takimi me studentë dhe stafin akademik të programit, GVJ konstatoi se studentët përfshihen në detyra, raste studimore. Gjithashtu referuar suplementit të diplomës, u konstatua se aty gjenden të dhëna të mjaftueshme për njohjen e kualifikimeve në nivel ndërkombëtar. Suplementi përmban nivelin, kontekstin, përmbajtjen dhe statusin e studimeve që ka ndjekur dhe përfunduar studenti.</p> <p><i>Evidenca 2.13: Suplementi “Bachelor në Menaxhim Turizmi 2017-2018</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet me stafin akademik, drejtues të njësisë kryesore dhe atë bazë si dhe referuar syllabuseve të lëndëve, konstaton se programet e lëndëve të programit, përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke rifreskuar lëndët me literaturë dhe botime bashkëkohore, por jo të gjitha lëndët, kanë literaturën e 5 viteve të fundit.</p> <p><i>Evidenca 2.13: Suplementi “Bachelor në Menaxhim Turizmi 2017-2018 VKM nr. 41, datë 28.01.2018 Evidenca 2.1: Literaturë e Miratuar në DB, për vitin 2019-2020</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ është e mendimit që përmbajtja e programi të studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave në fushën e menaxhimit të shërbimeve në turizëm, por që t’ju shërbejë specifikisht ofrimit të kompetencave dhe aftësive praktike sugjerohendryshimet në disa lëndë, të sugjeruara më sipër.</p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>GVJ siç është shprehur edhe më sipër, rekomandon që programi i studimit në mënyrë që të mundësojë punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, nëpërmjet kompetencave të fituara, të përshtatet në vazhdimësi, për të përfshirë ndryshimet në lëndët e sugjeruara më sipër.</p>
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa</p>	<p>Sipas RVB-sëdhe nga takimi me stafin akademik të DB, GVJ konstaton se departamenti ka një bashkëpunim të ngushtë me disa biznese të rajonit</p>

më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	si struktura hoteljere, Shoqatën e hotelierëve, Dhomën e Tregëtisë dhe të Industrisë Vlorë, për përshtatjen sa më të mirë të programit të studimit me tregun e punës.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p> <p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, ofrohet nga Departamenti i Biznesit në Fakultetin e Ekonomisë UV. Stafi akademik i aktivizuar në këtë program është në përputhje me fushën e programit të studimit dhe me eksperiencë relativisht të gjatë akademike. GVJ konfirmon se pas shqyrtimit të të dhënave të paraqitura në dokumentatsipas DVV rezultoi se numri dhe kualifikimi i stafit të angazhuar në këtë program studimi, në tre vitet akademike të fundit është si më poshtë:</p> <p>Për vitin akademik 2017-2018 janë angazhuar 25 pedagogë (24 PAE / 1 PAK):</p> <ul style="list-style-type: none"> - 4 Prof.Asoc; - 12 Dr; - 8 Msc; <p>Mbulimi i programit në përqindje është 96% PAE.</p> <p>Për vitin akademik 2018-2019 janë angazhuar 30 pedagogë (28 PAE / 2 PAK):</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 Prof.Dr; - 7 Prof.Asoc; - 10 Dr; - 10 Msc; <p>Mbulimi i programit në përqindje është 93% PAE.</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020 janë angazhuar 28 pedagogë (27 PAE / 1 PAK):</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 Prof.Dr; - 6 Prof.Asoc; - 14 Dr; - 6 Msc;

	<p>Mbulimi i programit në përqindje është 96% PAE.</p> <p>Për sa i përket ngarkesës së orëve në auditor në mbulimin e moduleve të programit për vitin 2019-2020 referuar planit mësimor (<i>Aneksi 1, Tabela 10</i>),rezulton se ngarkesa në auditor është 1725 orë dhe vetë 15 orë mbulohen nga stafi me kontratë.</p> <p>Mbulimi i ngarkesës në përqindje është 99 % nga PAE. Pra, personeli akademik efektiv (PAE) i angazhuar në programin e studimit përbën rreth 96% të personelit në total, ndërsa ngarkesa mësimore e realizuar nga personeli akademik efektiv është rreth 99%.</p> <p><i>Ligji i Arsimit të Lartë, nr.80/2015 Aneks 1:Tabelat 6.1-6.4 “Cilësia e stafit akademik për programin e studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”.Aneks 1:Tabelat 7 “Të dhëna të stafit akademik për programin e studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi” sipas kualifikimeve dhe raporteve midis tyre. Evidenca 2.15: CV-tëe personelit akademik angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”</i></p>
--	--

<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni, në marrëveshje me biznese turistike të rajonit, organizon praktikën mësimore të sudentëve të programit të studimit bachelor “Menaxhim Turizmi”, bazuar në Rregulloren e Uniuersitetit “Ismail Qemali” Vlorë.</p> <p>Nga RVB-ja dhe dokumentacioni i paraqitur nga insticioni, rezulton se institucioni angazhon personelin e duhur për të udhëzuar dhe udhëhequr studentëtnë praktikën profesionale dhe në përgatitjen temës së diplomës. Në materialet shoqëruese përshkruhen me hollësi procedurat e zhvillimit të praktikës si dhe udhëzimet për punimin e diplomës.</p> <p><i>Evidenca C:Rregullore e UV-së Evidenca 1.3:Rregullore e Programit të ciklit të parë të studimit “Menaxhim Turizmi”</i></p>
---	---

<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Në këtë program studimi zhvillohen orë laboratorike në lëndën e informatikës, ku institucioni për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, angazhon personelin e përshtatshëm ndihmës mësimor-shkencor.</p>
--	--

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin e informacionit të ASCAL, rezulton se ky institucion përkrah aplikimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe përdorimin e teknologjisë së informacionit në të gjitha njësitë kryesore dhe bazë, duke hartuar edhe një udhëzues në nivel institucioni.</p> <p>Në planin strategjik për vitet 2018-2024, Universiteti i Vlorës, synon të pasurojë infrastrukturën akademike në ndihmë të përdorimit të metodave të reja të mësimdhënies sipas lëndëve.</p> <p><i>Evidenca N: Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve</i> <i>Evidenca B: Plani Strategjik i UV-së 2018 – 2024</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>G VJ konstatoi se njësia kryesore, njësia bazë dhe Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Projekteve, nën varësinë e së cilës është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional (NJSBCVL), zhvillojnë mekanizma monitorimi me qëllim vlerësimin periodik dhe të vazhdueshëm të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Këto mekanizma fokusohen kryesisht në analizimin e të dhënave nga pyetësorët për studentët që organizohen nga NJSBCVL dhe në përpilimin e Planit të Masave për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në prgramet e studimit që ofron njësia kryesore.</p> <p><i>Evidenca A: Statuti i UV Evidenca 3.1: Vendim i Senatit Akademik, nr. 84, dt. 12.12.2016 Evidenca 3.2: Vendim i Senatit Akademik, nr. 8, dt. 14.02.2018 Evidenca 3.3: Vendim i Senatit Akademik, nr. 52, dt. 20.04.2018 Evidenca 3.4: Vendim i Senatit Akademik, nr. 21, dt. 08.05.2018 Evidenca 3.5: Vendim i Senatit Akademik, nr. 17, dt. 28.03.2019 Evidenca K: Raport mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve për vitin akademik 2017-2018 Evidenca L: Raport mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve për vitin akademik 2018-2019</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Nga informacioni i siguruar dokumentacioni i institucionit, rezultoi se studentët përfshihen në sondazhet për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. Drejtuesit e njesisë kryesore dhe asaj bazë angazhohen për trajtimin e ankimimeve, nëpërmjet metodave të cilat janë të sanksionuara në rregulloren e UV-së, ku përcaktohet mënyra e administrimit dhe e tranparencës në vlerësimin e dijeve.</p> <p><i>Evidenca C: Rregullore e UV-së Evidenca 3.6: Vendim i Senatit Akademik, nr. 94, dt. 13.10.2017</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Në Universitetin “Ismail Qemali” të Vlorës, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional si dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional, si njësi përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë së mësimdhënies, pasi realizon sondazhet e studentëve, rezultatet i dërgohen përgjegjësit të</p>

	njësisë bazë, njësisë kryesore si dhe u bëhen publike edhe pedagogëve.			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.	Departamenti i Biznesit pranë Fakultetit të Ekonomisë të UV-së, përgjegjës për programin e studimit që po akreditohet, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik <i>(mbështetje financiare për pjesëmarrje në konferenca dhe publikime në revista shkencore)</i> për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies. <i>Evidenca 1.4: Raport Vjetor i DB-së, 2018-2019</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Referuar rregullores së programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, planit mësimor si dhe syllabuseve të lëndëve të këtij programi, u konstatua se në këtë cikël studimesh përdoren forma alternative si leksione, seminare, detyra kursi, projekte individuale, provime të ndërmjetme dhe përfunimtare, praktika profesionale si dhe tema e diplomës. Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi” ofrohet i vlerësuar me kredite në përputhje me Sistemin Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS) ku, orët/kreditet e këtij cikli studimesh janë: <ul style="list-style-type: none"> • 180 Kredite të ndara në 3 vite akademike me 60 kredite secili; • Orë total 4650, ku, 1875 orë në auditor, (nga të cilat 1185 orë leksione 540 orë seminare, 150 orë praktika në terren) dhe 2775 orë jashtë auditorit; • Praktika profesionale 6 kredite • Detyrime përmbyllëse-Diploma 6 kredite
Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.	Bazuar në informacionet e grumbulluara në takimet online me studentët dhe stafin akademik të programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, rezultoi se, stafi akademik i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke përshtatur dhe ofruar mundësi dhe forma alternative të mësimdhënies, mësimnxënies dhe të kontrollit të dijës. Nga bashkëbisedimi me studentët e programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi” u konstatua se përveç leksioneve, gjatë seminareve krahas kontrollit të njohurive nëpërmjet pyetjeve/ përgjigjeve dhe diskutimeve, aplikohen edhe vizita studimore pranë bizneseve turistike apo enteve publike të cilat u mundësojnë studentëve lidhjen e argumetave teorike të trajtuara në lëndë specifike me aspektet praktike.
Kriteri 3. Institucioni mbështet	Nga takimet online me drejtuesit e njësisë kryesore dhe asaj bazë, rezultoi

<p>personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>se institucioni, me synimin e përmirësimit të kompetencave didaktike, të metodologjive të mësimdhënies, ka investuar në teknologji si dhe ka mundësuar trajnime për stafin akademik. Në funksion të kësaj, institucioni ka pajisur çdo pedagog të Departamentit të Biznesit, si përgjegjës për programin e studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, me bazën didaktike të nevojshme, si videoprojektorë etj., me personel ndihmës akademik dhe kërkimor shkencor si dhe ka mbështetur financiarisht trajnime dhe pjesëmarrje të pedagogëve në projekte kërkimore.</p>			
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Nga informacioni i siguruar nga studentët, gjatë takimit online si dhe referuar CV, fushave të ekspertizës dhe, eksperiencës së stafit, rezulton se stafi akademik është kompetent në shpjegimin e koncepteve dhe transmetimin e njohurive, nëpërmjet përdorimit të metodave të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit përkatës.</p> <p>Stafi akademik Departamentit të Biznesit pranë Fakultetit të Ekonomisë të UV-së, i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi, plotëson kriteret ligjore të kualifikimit. Personeli akademik përdor me kompetencë pajisjet në dispozicion të mësimdhënies si dhe ka punuar mjaft në pajisjen e studentëve me tekste dhe cikël leksionesh.ë</p> <p><i>Evidenca 2.15: CV-të e personelit akademik angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”</i></p>			
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Institucioni periodikisht vlerëson format dhe metodat e mësimdhënies, me qëllim përmirësimin e këtyre metodave në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional harton raportin e analizës së pyetësorëve të studentëve, i cili është burimi kryesor për marrjen e mendimeve dhe sugjerimeve nga studentët në funksion të përmirësimit të formave dhe metodave të mësimdhënies.</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.</p>	<p>Për ti bërë orët e mësimin më tërheqëse dhe më konkrete stafi akademik i Departamentit të Biznesit i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi, përdor metoda interaktive dhe diskutimi me studentët si dhe realizon ndërthurjen e teorisë me praktikën, nëpërmjet vizitave të studentëve në biznese të ndryshme, për ti bërë më të kapshme çështjet që lidhen me menaxhimin e shërbimeve në sektorë të ndryshëm të turizmit.</p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga informacioni i siguruar në takimin online me studentët e programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, GVJ konstatoi se metodat e mësimdhënies të përdorura nga stafi akademik pranë Departamentit të Biznesit, inkurajojnë autonomi tek studentët dhe sigurojnë marrëdhënie respekti të ndërsjellë.</p> <p>Studentët orientohen dhe inkurajohen të ndërmarrin iniciativa për realizimin e detyrave individuale, rasteve studimore, në organizimin dhe prezantimin e detyrave të kursit etj. Bashkëpunimi midis studentëve dhe pedagogëve realizohet si gjatë orëve të procesit mësimor ashtu edhe në orët e konsultimeve, si dhe nëpërmjet komunikimit online.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Nuk</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet</p>

standardit	përmbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p> <p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Referuar RVB-së, dhe vizitës në institucion realizuar nga një anëtare e grupit, GVJ konstatoi se sallat e leksioneve, seminareve dhe laboratorëve, janë të mjaftueshme. Në dispozicion të zhvillimit të mësimin nga studentët e programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, në godinën A të institucionit ndodhen: 11 auditore për leksione, 8 klasa për seminare, 1 laborator për zhvillimin e lëndës së informatikës, 1 sallë për bibliotekën, një zyrë informacioni për studentët si dhe 19 zyra për prsonelin. Këto mjedise rezultojnë brenda standardeve normale të mirëmbajtjes dhe kushteve higjeno-sanitare.</p> <p>Referuar RVB-së, rezulton se sallat në dispozicion të procesit mësimor të programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, disponojnë infrastrukturë dhe logjistikë të pranueshme dhe të nevojshme, poste ulje, tavolina, lidhje interneti, kompjutera, videoprojektorë etj. Gjithashtu mjediset ku zhvillohet procesi mësimor plotësojnë të gjitha kriteret teknike</p> <p><i>Aneks 1: Tabela 16 “Mjediset e fakultetit/njësive bazë”</i></p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Referuar RVB-së, personeli akademik dhe studentët e të gjitha cikleve, përfshirë edhe studentët e programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike si “Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Mësimor të UV-së (UVMS), lidhjen me WI-FI si dhe adresat elektronike të pedagogëve dhe studentëve, për të komunikuar në funksion të përmbushjes së procesit mësimor.</p> <p><i>Evidenca A: Statuti UV-së Evidenca 3.7: Vendim i Senatit Akademik, nr. 101, dt. 06.12.2017</i></p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>GVJ nga takimet online me stafin akademik, drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë si dhe referuar syllabuseve të lëndëve, konstaton se për shumicën e lëndëve të programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, literatura bazë ofrohet në gjuhën shqipe dhe përfshin tekste mësimore, cikle leksionesh, leksione në ppt etj. Gjithashtu, GVJ vëren se për disa lëndë, që i përkasin grupit të lëndëve të turizmit, literatura bazë në gjuhën shqipe mungon.</p> <p><i>Evidenca 2.1: Literaturë e Miratuar në DB, për vitin 2019-2020 Evidenca 2.3: Syllabuset e programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”</i></p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore</p>	<p>Referuar RVB-së, GVJ është i mendimit se biblioteka e institucionit disponon një numër të limituar botimesh në gjuhë të huaj të viteve të fundit. Për pasurimin e saj, me qëllim reflektimin e ndryshimeve cilësore të programit të studimit, institucioni ka marrë disa masa konkrete si p.sh.</p>

të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	realizimin e bibliotekës online. Mjediset e bibliotekës kanë hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët. <i>Vendimi i Senatit Akademik të UV-së</i> , për digjitalizimin e fondit aktual të librave e bën akoma më të përshtatshëm përdorimin e bibliotekës për procesin mësimor. <i>Evidenca 3.8: Vendim i Senatit Akademik, nr. 83, dt. 18.07.2017</i>			
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	GVJ gjatë kontakteve online me studentët dhe stafin akademik të institucionit si dhe referuar RVB-së, konstatoi se në funksion të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies personeli akademik dhe studentët mund të aksesojnë libraritë COBISS, ULIBRARY dhe EBSCO nga zyrat e tyre si dhe nga mjediset e bibliotekës. Studentët mund t'i shfrytëzojnë këto mjedise, në shërbim të detyrave të kursit, temës së diplomës etj. <i>Evidenca 3.9: Informacion i sektorit të bibliotekës shkencore në funksion të akreditimit të programeve të FE-së Aneks 1: Tabela 17 "Platformat online të UV-së"</i>			
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Nga informacioni i siguruar nga RVB-ja, studentët e programit të studimit Bachelor në "Menaxhim Turizmi", ofruar nga Departamenti i Biznesit, pranë FE, UV, kanë mundësinë që të shfrytëzojnë laboratorin e informatikës, në funksion të zhvillimit të mësimin në lëndë të ndryshme, si dhe të realizimit të detyrave të kursit, temës së diplomës etj.			
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Në UV, po aplikohet platforma online UVMS, e cila ofron mundësinë e komunikimit interaktiv mes pedagogëve dhe studentëve të programit <i>Evidenca 3.9: Manuali i përdorimit të UVMS</i>			
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Personeli akademik dhe studentët e UV-së, përdorin sistemin e komunikimit të brendshëm, nëpërmjet platformës elektronike UVMS, për të patur akses në dokumentacionin elektronik. Ky akses i sigurohet nëpërmjet hapësirës vetjake të dedikuar për secilin përdorues të UVMS ose adresës elektronike personale zyrtare.			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Nga informacioni i siguruar gjatë takimit online me stafin akademik, studentët si dhe dokumentacioni i depozituar në sistemin e ASCAL, personeli akademik i Departamenti të Biznesit, orienton studentët e programit të studimit Bachelor në "Menaxhim Turizmi" për përzgjedhjen e temës së diplomës sipas fushave të kërkimit që mbulon departamenti. Pedagogu udhëheqës, konform Rregullores së Programit të ciklit të parë të studimit "Menaxhim Turizmi" gjatë gjithë kohës asiston në zhvillimin e temës duke komunikuar në forma të ndryshme me studentin. <i>Evidenca 1.3: Rregullore e Programit të ciklit të parë të studimit "Menaxhim Turizmi"</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Referuar RVB-së dhe nga kontaktet e realizuara online, GVJ konstaton se, në nivel institucional, UV ka ngritur struktura të posaçme që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Sipas statutit dhe rregulloreve përkatëse, të miratuara nga Senati i UV-së, në institucion funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional, e cila koordinon dhe bashkërendon veprimtarinë e saj për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, me njësitë kryesore dhe ato bazë të UV-së.</p> <p><i>Evidenca 3.2: Vendim i Senatit Akademik, nr. 8, dt. 14.02.2018</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Sipas RVB-së, rezulton se në UV, Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Biznesit dhe më konkretisht Zv. Dekani për anën mësimore, Përgjegjësi i Departamentit dhe Drejtuesi i Grupit Mësimor Marketing-Turizëm janë përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët e programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”.</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Struktura përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies në Universitetin “Ismail Qemali” në Vlorë është Qendra Studimore Ndërdisciplinore e Zhvillimit Rajonal, e cila ka hartuar “Udhëzuesin mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimit”</p> <p><i>Evidenca 3.2: Vendim i Senatit Akademik, nr. 8, dt. 14.02.2018</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ, shqyrtimit të dokumentacionit konstatoi se personeli akademik, ka rritje kualifikuese nga viti në vit ku vërehet shtimi i pedagogëve me tituj dhe grada. Stafi i Departamentit të Biznesit, që mbulonlëndët e planit mësimor të programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, është në proces të vazhdueshëm kualifikimi sipas fushës individuale kërkimore-shkencore dhe mesimore. Pjesëmarrja në seminare, trajnime, workshope, projekte dhe konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare flasin për përpjekje të vazhdueshme në drejtim të kërkimit shkencor në ndihmë të përmirësimit të mësimdhënies nga stafi akademik i departamentit.</p> <p><i>Aneks 1: Tabela 19 “Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik përgjegjës për programin e studimit”</i></p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të</p>	<p>Sipas RVB-së, në UV nuk ekzistojnë struktura apo njësi për trajnimin e personelit akademik në përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja, por në funksion të kësaj institucioni mbështet vazhdimisht stafin për pjesëmarrje në projektet kërkimore (IPA).</p>

reja.				
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik që është përgjegjës për zhvillimin e programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi” bën përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. Kjo gjë dëshmohet edhe nga <i>Certifikimi CHE nga AHLEI</i> i pedagogëve që japin mësim në këtë program studimi.			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	GVJ, konstaton se personeli ndihmës akademik, është i angazhuar në realizimin e detyrave në funksion të zbatimit të programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi” si dhe për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, gjë që reflektohet gjatë transmetimit të njohurive tek studentët sipas moduleve. Sipas RVB-së kjo gjë është mundësuar nëpërmjet mobiliteteve ERASMUS+ dhe marrëveshjeve të partneritetit me një sërë universitetesh brenda dhe jashtë vendit. Por lidhur me këtë theksohet se nuk ka analiza të pritshmërive dhe raportim në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstatoi në dokumentacionin e depozituar nga institucioni, se mënyra e testimit dhe e vlerësimit të njohurive, përcaktohen në rregullore të posaçme siç janë <i>Rregullorja e Universitetit (Evidenca C)</i> , <i>Rregullorja e Departamentit të Biznesit (Evidenca 2.2)</i> , si dhe <i>Rregullorja e Programit të ciklit të parë të studimit “Menaxhim Turizmi”(Evidenca1.3)</i> . Rregulloren e Universitetit studentët e gjejnë të publikuar në faqen online të unversitetit, ndërsa me dy rregulloret e tjera njihet qe në ditët e para të vitit të parë të studimeve.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	GVJ, nga takimi online me studentët dhe stafin akademik, konstatoi se studentët në zbatim të rregulloreve të sipërpërmendura, informohen nga stafi akademik në fillim të çdo lënde për, programin e lëndës, format alternative të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale si dhe detyrimet që studentët kanë, informacione këto që studentët mund t’i gjejnë edhe në syllabuset e lëndëve.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra	Referuar rregullores së programit dhe syllabuseve, rezulton se në syllabus janë parashikuar format e vlerësimit dhe masa e vlerësimit të çdo komponenti. Kontrolli i dijes për studentët, realizohet nëpërmjet:

të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	<ul style="list-style-type: none"> - vlerësimin me pikë e provimit të ndërmjetëm, - detyrave të kursit dhe - provimit përfundimtar, <p>shuma e cilëve konvertohet në notë. Këto forma janë alternative dhe të ndryshme duke iu dhënë mundësi studentëve, të demonstrojnë njohuritë e përfituara.</p> <p><i>Evidenca 1.3: Rregullore e Programit të ciklit të parë të studimit "Menaxhim Turizmi"</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	GVJ, referuar syllabuseve, stafit akademik dhe studentëve, konkludon se vlerësimi është semestral, me komponentë të tillë si aktivizimi në seminare, provimi i ndërmjetëm dhe detyra e kursit, që përbëjnë vlerësimin e vazhduar në masën 35-45% të vlerësimin total të studentit dhe vlerësimin përfundimtar që realizohet me provimin final në masën 55%-65% të vlerësimin total. Të gjithë komponentë treflektohen në vlerësimin final.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimin të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Referuar RVB-së, konstatohet se në UV nuk bëhet testimi dhe vlerësimi i studentëve nëpërmjet sistemeve elektronike. Ndërkohë stafi akademik komunikon me studentët nëpërmjet platformës UVMS për vlerësimin dhe rezultatet e tyre, gjë që krijon mundësi për më shumë transparencë dhe për të zvogëluar format e abuzimit.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Nga komunikimi me stafin akademik dhe drejtuesin e njësisë bazë, rezulton se testimi përfundimtar realizohet nga një komision, i cili rezulton se ka jo më pak se 2 anëtarë, ndërsa komisioni i provimit të diplomës përbëhet nga 5 anëtarë. Këto komisione miratohen nga përgjegjësi i Departamentit të Biznesit. Në komisionin e provimit të lëndës, njëri nga anëtarët është lektori i lëndës. <i>Evidenca 1.3: Rregullore e Programit të ciklit të parë të studimit "Menaxhim Turizmi"</i>
Kriteri 4. Testimi i vlerësimin i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	GVJ konstaton se studentët monitorohen nga komisioni gjatë gjithë provimit, për të siguruar kushtet e zhvillimit korrekt. Provimet realizohen në përputhje me <i>Rregulloren e Programit të ciklit të parë të studimit "Menaxhim Turizmi"</i> , e cila nuk parashikon zhvillimin e provimeve në mënyrë anonime. Materialet e provimeve deri në nxjerrjen e rezultatit janë nën përgjigjësinë e pedagogut përkatës, më tej ato çohen në sekretarinë e Departamentit të Biznesit të mbyllura në zarf, mbi të cilin shkruhen të gjitha të dhënat dhe firmosen nga lektori.
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive,	

<p>dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Referuar RVB-së, rezulton se stafi akademik i angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, këshillon dhe orienton studentët në lidhje me të gjithë elementet e vlerësimit të dijeve dhe aftësive profesionale me qëllim për të ndihmuar studentët të përmirësohen në mësimnxënien. Rezultatet e vlerësimit ju komunikohen studentëve në sistemin UVMS brenda 48 orëve nga dita e zhvillimit të provimit. Gjithashtu, sipas rregulloreve në fuqi studentët, pasi të marrin rezultatin kanë mundësi të konsultojnë vlerësimin e marrë, për përmirësimin e rezultatit të tyre në të ardhmen.</p> <p><i>Evidenca 1.3: Rregullore e Programit të ciklit të parë të studimit “Menaxhim Turizmi”</i></p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Provimet zhvillohen me mbikëqyrje nga komisioni për të shmangur kopjimin. Kopjimi në provime si dhe plagjatura e punimeve të studentëve bie ndesh me dispozitat e Kodit të Etikës së UV-së dhe Rregullores së Programit të ciklit të parë të studimit “Menaxhim Turizmi”.</p> <p><i>Evidenca 1.3: Rregullore e Programit të ciklit të parë të studimit “Menaxhim Turizmi” Evidenca E: Kodi i Etikës</i></p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Studentët e programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, vlerësimet i marrin në kohën e përcaktuar sipas rregulloreve përkatëse. Studentët vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme përgjatë gjithë semestrit, vlerësime këto që janë komponentë të vlerësimit final. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale i komunikohen studentëve konform rregullores së universitetit dhe asaj të programit të studimit. Nëse studenti, gjykon se vlerësimi i tij nuk është bërë në bazë të meritës ka mundësinë e ankimit.</p> <p><i>Evidenca C: Rregullore e UV-së” Evidenca 1.3: Rregullore e Programit të ciklit të parë të studimit “Menaxhim Turizmi”</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të depozituar në ASCAL nga institucioni, studenti ka të sanksionuar të drejtën për tu njohur me vlerësimin, me mënyrën e korrigjimit, për të qenë i qartë për gabimet në përgjigje dhe për vlerësimin sipas meritës. Referuar rregulloreve përkatëse, studentët kanë të drejtën të ballafaqohen me stafin mësimdhënës në lidhje me vlerësimin e provimeve. Mbas këtij ballafaqimi ata kanë të drejtën për të kërkuar rishikim të vlerësimit në rast të paqartësive.</p> <p>Në dokumentacionin e depozituar të institucionit, si rregullore institucioni dhe programi, GVJ konstaton, se studenti gjithashtu e ka të sanksionuar të drejtën e ankimit për rezultatet. Procedura e ndjekur për ankimim, për zgjidhjen e ankesës si dhe vendimi i marrë realizohet në afate të përcaktuara. Ankesat shqyrtohen nga një komision ad-hoc i ngritur nga përgjigjësi i departamentit me miratim të dekanit, i cili bën edhe vlerësimin përfundimtar të studentit. Nëse ka ndryshme në vlerësim këto pasqyrohen në një procesverbal të ri që i bashkangjitet procesverbalit të mëparshëm.</p> <p><i>Evidenca C: Rregullore e UV-së” Evidenca 1.3: Rregullore e Programit të ciklit të parë të studimit “Menaxhim Turizmi”</i></p>

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Referuar informacionit të siguruar nga dokumentacioni i depozituar në sistem nga institucioni, rezulton se program i studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, i cili përmban 28 lëndë në tre vite mësimore, garanton thellimin e njohurive dhe zhvillon aftësitë profesionale të studentëve në funksion të aplikimit të metodave teorike dhe praktike në menaxhimin e shërbimeve turistike.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Referuar planit mësimor të programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, rezultoi se nga mënyra e konceptimit të tij dhe pjesëmarrja në të veprimtarive dhe disiplinave formuese gjuhët e huaja, informatika, sistemet e infomacionit praktika profesionale etj., bëjnë që ky program të garantojë studentëve zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Referuar RVB-së, dhe nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve të programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, rezulton se kompetencat dhe aftësitë që duhet të fitojë studenti nga ky program janë të shprehura qartë në syllabuset e çdo lënde. Në fund të semestrit, nëpërmjet analizës së rezultateve nga anketimi i studentëve, institucioni vlerëson kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti nga ky program studimi.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Referuar informacionit të siguruar nga studentët e programit si dhe nga pedagogët, në seancën e fundit të semestrit, në orën e seminarit si dhe gjatë orëve të konsultimit, çdo pedagog realizon një përmbledhje të lëndës, të temave kryesore nxjerr në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.
Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Nga informacioni i siguruar nga dokumentacioni, rezultoi se për studentët e programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, janë organizuar me ekspertë të fushës së turizmit, vendas dhe të huaj për të diskutuar mbi zhvillimet e reja të shkencës dhe teknologjisë. <i>Evidenca 3.12: Kërkesë për pedagogë të ftuar</i>
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Referuar planit mësimor, syllabuseve si dhe takimeve online me stafin dhe studentët e programit, rezulton se në procesin e mësimdhënies organizimi i orës së mësimi i përshtatet natyrës së lëndëve dhe synon angazhimin e të gjithë studentëve për një mësimnxënie optimale, zhvillim kompetencash si dhe aplikim të njohurive të siguruara nga teoria në laboratorë dhe

	praktikat profesionale. <i>Evidenca 3.13:Procedurë praktike profesionale</i>			
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Referuar RVB-së dhe nga takimet online me stafin akademik dhe studentët e programit, rezulton se personeli akademik i DB, veçanërisht pedagogët që mbulojnë lëndët e turizmit, gjatë orëve të procesit mësimor si dhe në veprimtari lidhur me zhvillimin e turizmit, mbështetin diskutimet dhe punën në grup të studentëve në interpretimin dhe zgjidhjen e çështjeve të caktuara të sektorit të turizmit.			
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Stafi akademik mbështet idetë inovative të studentëve në zgjidhjen e problemeve të menaxhimit të shërbimeve turistike dhe identifikon momentet që kanë nevojë për më shumë informacion dhe studim të mëtejshëm. Këto probleme bëhen objekt i kërkimeve të mëtejshme duke u materializuar në tema diploma edhe pse në një numer të vogël diplomash për shkak të numrit të ulët të studentëve që plotësojnë kriterin e mesatares për temë diplome.			
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	Nga informacioni i siguruar nga dokumentacioni, rezultoi se studentët e programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, përfshihen në kërkim, nëpërmjet diplomave si dhe pjesëmarrjes në projekte të ndryshme. Në punën e tyre kërkimore e shkencore, studentët nuk mbështeten financiarisht nga institucioni por ata mbështeten me fonde nga projektet ku UV-ja është partnere.			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	GVJ konstaton përpjekje të institucionit nëpërmjet marrëveshjeve me institucione të arsimit të lartë të huaja si dhe projektit ERASMUS+, ka mundësuar mobilitetin e stafit akademik. Po shikohen mundësitë edhe për realizimin e mobiliteteve për studentë e programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Referuar rregullores së programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, cikli i parë i studimeve Bachelor përmbyllet me provimin final ose me punim diplome. Procedura e përmbylljes së studimeve bachelor i bëhet publike studentëve të vitit të tretë nëpërmjet një takimi të organizuar nga drejtuesi i njësisë bazë në fillim të semestrit. <i>Evidenca 1.3: Rregullore e Programit të ciklit të parë të studimit “Menaxhim Turizmi”</i>

<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Nga takimet online me stafin akademik dhe studentët e programit të studimeve Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, rezultoi se strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët duke vënë në dispozicion të tyre të gjitha informacionet e nevojshme në funksion të provimit final dhe përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës sipas rregullores së programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 1.3: Rregullore e Programit të ciklit të parë të studimit “Menaxhim Turizmi”</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Referuar rregullores së Programit të Studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, si cikli i parë të studimeve që nuk plotësojnë kriterin e mesatares për mbrojtjen e diplomës i nënshtrohen provimit final, i cili bazohet në testimin e njohurive të dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike të tyre.</p> <p><i>Evidenca 1.3: Rregullore e Programit të ciklit të parë të studimit “Menaxhim Turizmi”</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Referuar RVB-së dhe nga takimet online me stafin akademik dhe studentët e programit, rezultojnë se drejtuesi i DB, drejtuesi Grupit Mësimor Marketing-Turizëm si dhe pedagogët udhëheqës të të temave të diplomës, orientojnë dhe ndihmojnë studentët në përgatitjen e provimit final si apo të temës së diplomës.</p> <p><i>Evidenca 1.3: Rregullore e Programit të ciklit të parë të studimit “Menaxhim Turizmi”</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>GVJ është e mendimit se institucioni ka kapacitetet e duhura për ti asistuar studentët në përgatitjen e punimit të temës sipas fushës së studimit, duke i krijuar mundësi në grumbullimin e të dhënave sekondare apo informacioneve në funksion të temës, nëpërmjet bashkëpunimit me ente publike dhe biznese turistike që operojnë në rajonin e Vlorës.</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p> <p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Pedagogu udhëheqës i diplomës miraton temën e përzgjedhur në dakordësi me studentin. Pas përcaktimit të programit të punës së studentit, për realizimin e diplomës si dhe afatet e përfundimit të saj, ai është në kontakt të vazhdueshëm me studentin. Gjatë konsultimeve me të, udhëheqës i kontrollon punën e realizuar sipas programit si dhe asiston studentët në përcaktimin e modeleve, në përpunimin e të dhënave etj, me qëllim realizimin e temës brenda kriterëve dhe standardeve të përcaktuara. Në fund udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studenti si dhe lejon mbrojtjen e tij, duke e nënshkruar.</p> <p>Referuar rregullores së programit, mbrojtja e diplomes mund të realizohet me një provim me gojë ose përgatitjen e një teme diplome. Komisioni i mbrojtjes propozohet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit dhe është i përbërë nga 5 anëtarë. Bazuar përgjigjen e dhënë apo në prezantimin e punimit studentit vlerësohet me notë. Nota për studentët që japin provimin final bazohet në mesataren e thjeshtë të notave të secilit anëtar të komisionit, ndërsa për studentët që mbrojnë temë diplome, nota bazohet në vlerësimin e udhëheqësit dhe punimin e studentit. Rezultatet e mbrojtjes së temës u bëhen me dije studentëve në fund të ditës.</p>

	<i>Evidenca 1.3: Rregullore e Programit të ciklit të parë të studimit “Menaxhim Turizmi”</i>			
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Siç është e parashikuar në nenin 16 të rregullores së programit të studimeve Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, në përfundim të studimeve, studentët, që kanë plotësuar të gjitha detyrimet e prëgramit mësimor si dhe detyrimet financiare, pajisen me diplomën dhe suplementin e diplomës. <i>Evidenca 1.3: Rregullore e Programit të ciklit të parë të studimit “Menaxhim Turizmi” Evidenca 3.14: Model diplome Evidenca 3.15: procedura e diplomimit</i>			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve të ciklit të parë, çdo student i vihet në dispozicion lista e notave dhe suplementi i diplomës. Ndërsa një kopje e plote zyrtare e programit të studimit i vihet në dispozicion studentit, vetëm me kërkesë të tij. <i>Evidenca 2.13: Suplementi Bachelor në Menaxhim Turizmi 2017-2018 Evidenca 1.3: Rregullore e Programit të ciklit të parë të studimit “Menaxhim Turizmi”</i>			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Dokumentacioni për studentët i plotësuar në kompjuter apo me dorë, ruhet për një kohë të pacaktuar nga institucioni nëpërmjet sekretarive mësimore të fakulteteve, si në hard-copye dhe në formë elektronike. Institucioni paraqet rast pas rasti informacione për studentët nëse kërkohen dhe përpunimi i të dhënave bëhet në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen e të Dhënave Personale në Shqipëri”. <i>Evidenca C: Rregullore e UV-së</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna	GVJ gjatë takimeve on-line si dhe nga konsultimi i dokumentacionit të depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL, rezulton se Zyra e burimeve njerëzore ruan të dhëna të plota për stafin akademik si dhe atë ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ, të cilët janë të angazhuar në

<p>përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësitor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>cdo vit akademik dhe cdo semestër në programin e studimit “Menaxhim Turizmi”, niveli Bachelor.</p> <p>Këto të dhëna, përmbajnë emrat e stafit akademik, lëndët për cdo semestër, orët mësimore dhe ngarkesën totale.</p> <p><i>(Evidenca 4.1.PDF)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Referuar RVB, dokumentacioni në sistemin e informacionit të ASCAL si dhe takimit on-line me përfaqësues të Zyrës së burimeve njerëzore në UV, rezulton se procedurat e rekrutimit janë zhvilluar në përputhje me Statutin e UV, neni 5 dhe Rregullores se UV, nenet 27 dhe 28.</p> <p>Rezulton se ka nje koordinim mes njësisë bazë përgjegjëse për këtë program si dhe zyrës së Burimeve Njerëzore në nivel institucioni, me përgjegjësi të ndara dhe në përputhje me bazën ligjore dhe aktet e brendshme rregullatore.</p> <p><i>(Evidenca A- Statuti i UV-së.pdf; Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Referuar procedurës së rekrutimit të konsultuar gjatë takimit on-line, GVJ konstaton se UV, harton kërkesa të përgjithshme, kritere bazë si dhe kritere preferenciale për stafin e programit.</p> <p>Referuar webit të UV, rezulton se institucioni publikon ne faqen e internetit, thirrjet për punësim të stafit akademik efektiv dhe atyre me kohë të pjesshme.</p> <p>Në këtë thirrje rezulton e publikuar edhe procedura si dhe metodologjia e vlerësimit nga komisioni ad hoc.</p> <p>GVJ rekomandon publikimin e thirrjeve për punësim edhe në burime të tjera alternative sic është faqja e APP, apo media vizive dhe e shkruar duke i sherbyer kështu shpërndarjes së informacionit në shkallë më te gjerë, duke rritur visibilitetin e thirrjes për të rritur numrin e aplikantëve cilësore, referuar kjo dy procedurat e konsultuara, për të vend vakant si staf me kohë të plotë dhe staf me kohë të pjesshme, ku ka aplikuar vetëm nga 1 kandidat</p> <p><i>(Evidenca 4.2.pdf) (https://univlora.edu.al/2019/10/28/universiteti-ismail-qemali-vlore-shpall-njofitim-per-vendin-e-lire-te-punes-Inje-personel-akademik-me-kohe-te-pjesshme-per-vitin-akademik-2019-2020-prane-departmentit-te-ekono/)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të</p>	<p>Mbështetur në procedurën e konsultuar gjatë takimit on-line, si dhe asaj që është pjesë e DVV (dosjes së vetëvlerësimit) për staf akademik, GVJ konstaton se procedura e rekrutimit si dhe vlerësimi mbështeten në kriteret e publikuara dhe në metodologjinë e vlerësimit të publikuar në thirrjen për punësim.</p> <p><i>(Evidenca 4.2.pdf DVV)</i></p>

studimit.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barMTarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	<p>Nga RVB si dhe nga diskutimet me stafin akademik te programit, rezulton se UV ka siguruar investime të cilat ofrojnë mjedise dhe zyre me kushte të pranueshme për stafin akademik dhe atë jo akademik. Për stafin akademik si dhe nga diskutimet me safin akademik të programit, ka një zyrë për 3-4 pedagogë, të pajisur me infrastrukturën e nevojshme</p> <p><i>(Evidenca 2.7 Infrastruktura.PDF)</i></p>
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	<p>GVJ konstaton në planin strategjik të institucionit si prioritet zhvillimin e profesional dhe akademik të stafit. Referuar takimeve me GVB, me stafin e programit si dhe drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë, rezulton se institucioni mbështet stafin akademik duke suportuar pagesat e regjistrimeve në konferenca shkencore ku ata marrin pjesë.</p> <p>Kjo është një praktikë e vlerësueshme motivuese, por GVJ sugjeron nje qasje më proaktive nga ana e institucionit, në formatin e një politike motivuese e sanksionuar për gjithë stafin akademik, e planifikuar në buxhetin vjetor e cila do të nxiste një përfshirje më të gjerë të stafit akademik të programit në aktivitete shkencore dhe që do të shërbente edhe si bazë për vlerësimin e performancës së stafit.</p> <p>Në kudër të programit Erasmus +, UV ka marrëveshjeve të përbashkëta me universitete të huaja, të cilat krijojnë mundësi për stafin akademik të krijojnë eksperiencia mësimdhëniejeje në këto universitete dhe te mund të përfitojnë profesionalisht prej këtyre eksperiencave, por këto duhen intensifikuar në të ardhmen dhe në to të jenë përfitues më shumë anëtarë të stafit akademik të programit. Duke iu referuar të dhënave të siguruar, rezulton që gjatë 2018-2019 të ketë përfituar një pedagog i fakultetit të Ekonomisë</p> <p><i>(Takimi on-line, Evidenca 3. Trajnim stafi ne fushen e mesimdhënies.PDF ;Lista e projekteve ku UV është lider-partner.pdf; VI; https://univlori.edu.al/sektori-projekteve/statistika/)</i></p>
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	<p>Referuar RVB si dhe takimeve on-line, me drejtues dhe me stafin e programit, GVJ nuk konstatoi iniciativa të institucionit apo organizime të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor ku stafi akademik i këtij programi të ketë marrë pjesë. Në takimin on-line me stafin akademik, rezultoi vetëm një rast i trajnimit i zhvilluar individualisht.</p> <p>Pavarësisht kësaj situate, GVJ referuar dokumentacionit në sistem vlerëson pozitivisht iniciativën e institucionit dhe miratimin e udhëzuesit në nivel</p>

	<p>institucional, implementimi i të cilit në të ardhmen do të ketë efekte pozitive në metodat inovative të mësimdhënies dhe përdorimin e tyre.</p> <p><i>(Evidenca 3. Trajnim stafi ne fushen e mesimdhënies.PDF ;Evidenca N-Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Referuar strukturës organizative të institucionit, stafit akademik dhe joakademik të përfshirë në programin Bch në Menaxhim Turizmi, si dhe nga informacioni i siguruar nga drejtues të njësisë bazë dhe asaj kryesore, në takimet on-line, rezulton se UV vë në dispozicion të PS Bsc në “Menaxhim Turizmi” staf të angazhuar dhe optimizion përdorimin e burimeve njerëzore për realizimin e objektivave të këtij PS.</p> <p>Referuar shpërndarjes së ngarkesës, rezulton se personeli akademik efektiv (PAE) i angazhuar në programin e studimit përbën rreth 96% të personelit në total, ndërsa ngarkesa mësimore e realizuar nga personeli akademik efektiv është rreth 99%. Kjo shpërndarje siguron njëangazhim dhe përfshirje të lartë të stafit efektiv të programit, duke i shërbyer realizimit të objektivave të programit të studimit Bsc në Memnaxhim Turizmi. Pavarësisht kësaj shpërndarje, ngarkesa e stafit është e pranueshme, duke qenë se numri i studentëve është i vogël dhe nuk ka kurse dhe grupe paralele</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>GVJ referuar DVV dhe evidencave të siguruarra për kapacitetet infrastrukturale të UV në dispozicion të PS Ba në Menaxhim Turizmi si dhe takimeve on-line, është i mendimit se UV siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, e ndikuar kjo edhe nga investimet e bëra për përmirësimin e kushteve fizike të sallave të leksioneve/ seminareve dhe jo vetëm, por edhe nga zvogëlimi i numrit të studentëve të rregjistruar, duke krijuar më tepër mundësi për ata që kanë zgjedhur këtë program studimi. Gjithashtu zhvillimi i mësimit në hapësira në përputhje me numrin e studentëve, favorizohet edhe nga zhvillimi i procesit mësimor në dy fasha orare, edhe pse studentët e PS në Bsc “Menaxhim Turizmi” e zhvillojnë procesin mësimor në orarin 8.00-14.00, si dhe nga numri i vogël i studentëve, në këtë program. <i>(Evidenca 2.7. Infrastruktura.PDF)</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion, konstatoi se në dispozicion të studentëve të PS në Bsc Menaxhim Turizmi është një laborator informatike me kapacitet 25 poste, i pajisur me PC, Skaner,</p>

<p>informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p> <p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Videoprojektor etj. Ky laborator është në dispozicion të studentëve të PS, në disa lëndë, por nuk ka programe specifike për PS BA në MT, sikundërezultoi nga takimi me GVB si dhe nga RVB.</p> <p>Për sa më sipër GVJ sugjeron intensifikimin e përpjekjeve nga ana e institucionit që të pajisë me softe specifike këtë laborator, për studentët e Bsc MT, të cilët duhet të jenë të orientuar drejt praktikës dhe njohurive të aplikuara dhe se këto softe i rrisin këto mundësi.</p> <p>Referuar RVB dhe komunikimit me studentët, rezulton se sallat në dispozicion të procesit mësimor të PS BA në MT, disponojnë infrastrukturë dhe logjistikë të pranueshme dhe të nevojshme, poste ulje, tavolina, pod lekturimi, white bord.</p> <p>Në klasa, referuar vizitës së mëhershme fizike në institucion nuk u konstatuan videoprojektorë, kompjutera apo pajisje të tjera të teknologjisë së informacionit, por nga takimet me studentë rezultoi se sipas disiplinave të ndryshme, profesorët mund t'i kenë mjetet audiovizive portabile.</p> <p>Institucioni duhet të realizojë edhe mbulimin e vazhdueshëm me internet të këtyre hapësirave, si domosdoshmëri për përdorimin e teknologjive të informacionit si dhe metodave alternative të mësimdhënies.</p> <p><i>(Evidenca 2.7. Infrastruktura.PDF)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Nga takimi on-line me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë përgjegjëse për PS në Menaxhim Turizmi si dhe nga studentët, praktikant ata i zhvillojnë pranë strukturave hoteliere me të cilat UV ka marrëveshje të cilat disponojnë kapacitetet pritëse infrastrukturale të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e praktikave të tyre.</p> <p><i>(Aneksi 1, Tabela 5 RVB)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedisë mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedisë të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>UV vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore. Kjo bibliotekë rezulton biblioteka qendrore e institucionit dhe është në shërbim për studentët e disa njësisë kryesore. Referuar evidencave për infrastrukturën e UV, sipërfaqja e saj është 250 m² me 60 poste dhe 9 PC.</p> <p>GVJ rekomandon zgjerim të hapësirës së bibliotekës dhe përmirësim të kushteve të saj infrastrukturale, numer fizik postesh, vendosje të më shumë</p>

	<p>PC, për të qenë një mjedis më funksional dhe për të siguruar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e PS Bsc në Menaxhim Turizmi, duke qenë se kjo është biblioteka qendrore e institucionit, në shërbim të studentëve dhe stafit akademik, të shumë programeve studimi bachelor dhe master, edhe të njësive të tjera kryesore.</p> <p><i>Evidenca 3.9</i></p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ referuar evidencës 3.9 të DVV, vlerëson iniciativat e institucionit për pasurim të vazhdueshëm të bibliotekës.</p> <p>Pavarësisht këtij fondi ekzistues, GVJ rekomandon se UV duhet të zgjerojë fondin e bibliotekës me një gamë më të gjerë librash në gjuhën shqipe dhe angleze, revistash shkencore, periodikë, si dhe me shumë literaturë bashkohore për programin e studimit PS në Bsc në “Menaxhim Turizmi”, duke qenë se edhe literatura bazë duhet të jetë e 5 viteve të fundit por edhe ajo ndihmëse duhet të jetë një literaturë e pasur bashkëkohore.</p> <p><i>Evidenca 3.9.PDF</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p> <p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Rezultoni se institucioni ofron akses të barabartë dhe pa pagesë për studentët për të shfrytëzuar data bazën e literaturës që është në dispozicion të tyre. Studentët kanë mundësinë e shfrytëzimit të U-library nëpërmjet sistemit të garantuar nga marrëveshja ndër-institucionale me RASH.</p> <p>Pavarësisht kësaj, nga takimi me studentët rezultoi se ata shfrytëzonin pak bibliotekën e institucionit dhe nuk kishin dijeni për potencialet e saj fizike apo elektronike. Vetëm një prej studentëve ishte i regjistruar në bibliotekë.</p> <p>Për sa më sipër institucioni GVJ është e mendimit se strukturat respektive të UV, duhet të angazhohet në nxitjen dhe ndërgjegjësimin e studentëve për përdorimin e bibliotekës dhe të data bazës së saj.</p> <p>GVJ konstaton se Biblioteka qendrore e UV, është në dispozicion të studentëve në orare të zgjatura nga e hëna në të premte, nga ora 8.00-20.00 dhe është në përputhje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor në PS Bsc “Menaxhim Turizmi”.</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka disponon 9 PC dhe disa pajisje të tjera si skaner, fotokopje të cilat, sugjerohen që të jenë në shfrytëzim pa kufizime nga studentët.</p> <p>Studentët mund të aksesojnë edhe librarinë elektronike nëpërmjet sistemit të Ulibrary. Sic shprehet edhe në RVB, biblioteka nuk është e pajisur me programe kompjuterike. GVJ vlerëson iniciativën e institucionit për dixhitalizimin e bibliotekës dhe që mbas implementimit do të ofrojë shërbime më të mira për studentët</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>GVJ nga të dhënat e siguruar nga DVV se nga ana e institucionit për vitin akademik 2016-2017 si dhe 2017-2018 ishin realizuar blerje të literaturës ekonomike.</p> <p>GVJ gjatë takimit on-line me drejtues të njësive bazë, konstaton se Departamenti Biznesit, ka përcjellë kërkesat buxhetore, mes të cilave që më vete konstatohet pasurimi i Bibliotekës dhe titujt e sugjeruar nga</p>

	departamenti.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p> <p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p> <p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p> <p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Referuar RVB, si dhe Evidencave të DVV, GVJ konstaton se UV disponon një sistem të menaxhimit të informacionit UVMS që siguron akses për këta përdorues: studentët, stafin akademik, sekretaritet si dhe zyrën e IT. Përvec sistemit elektronik të mësipërm, për studentët informacioni mbahet edhe në formë shkresore, nëpërmjet regjistrimit themeltar, regjistrimit të përparimit akademik të studentëve, si dhe regjistrimit të lëshimit të diplomave, të cilat u konstatuan nga ana e GVJ gjatë takimit on-line me zyrën e sekretarisë mësimore, dhe që rezultuan me informacione e plotë të kërkuar.</p> <p>Nga takimet on-line me stafin akademik, studentët si dhe sekretarinë, përvec formës shkresore të ruajtjes së informacionit si më sipër, UVMS rezultoi të jetë aktiv prej 2017 dhe të ofrojë në mënyrë efektive dhe koherente: informacion për studentët dhe vlerësimet e tyre, procesverbalet e lëndëve të ndryshme, mundësi komunikimi interaktiv mes studentëve dhe stafit akademik, lehtësi në menaxhimin e informacionit për sekretaritet etj.</p> <p>Përdoruesit e sistemit rezultojnë të kenë akses të dedikuar në sistem nëpërmjet kredencialeve të tyre personale, nga takimi on-line me stafin akademik, rezultoi se stafi akademik informon studentët për rezultatet nëpërmjet sistemit, studentët informohen në kohë reale për to, kanë të drejtën të paraqesin kërkesat për rishikim nëpërmjet sistemit e të informohen edhe për vlerësimin e tyre final</p> <p>Sistemi elektronik i informacionit të menaxhimit, rezultoi një sistem i integruar me platforma dhe module që suportojnë komunikimin interaktiv mes studentëve dhe stafit akademik.</p> <p>GVJ sugjeron që ky sistem të përdoret edhe si mundësi për mësimin on-line, si mundësi për ofrimin e leksioneve, PPT, ratseve studimore, videove në shërbim të të studentëve.</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha</p>	<p>Institucioni ka një faqe interneti me informacion të përmbledhur për të gjitha njësitet kryesore. (https://univlora.edu.al)</p> <p>Referuar webit të UV, ai ofron informacion për personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme në gjuhën shqipe aktualisht. Përsa i përket informacionit në gjuhën angleze, aktualisht webi nuk e ofron., por nga</p>

shqipe.	<p>takimet on-line, rezultoi se institucioni ka investuar në riorganizimin e faqes zyrtare të internetit, e cila konsiderohet me informacion të plotë edhe në gjuhë angleze, por duke qenë se institucioni është në proces akreditimi institucional, ende nuk ka e ka aktivizuar faqen e riorganizuar, për të mos humbur informacionin dhe adresat respektive të këtij informacioni, për qëllim referimi.</p> <p>Pavarësisht për sa më sipër, rekomandohet që faqja e internetit të jetë më e decentralizuar, duke krijuar mundësi edhe për kalimin në faqe interaktive të cdo njësie kryesore, duke ofruar një organizim më efektiv të informacionit, për kategori specifike përdoruesish të interesuar për Fakultetin e Ekonomisë dhe programet e studimit që ky fakultet ofron.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>GVJ konstaton se në zbatim të legjislacionit në fuqi, UV harton një raport vjetor. Pjesë e këtij raporti rezultojnë të jetë edhe raportimi financiar i cili kalon për miratim në senat dhe më pas në bordin e Administrimit. Ky raport rezultojnë të jetë i publikuar në webin e UV. GVJ konstaton se kostot raportohen si kosto mesatare/student në nivel institucioni.</p> <p>GVJ sugjeron që institucioni të bëjë analizë të kostove në nivel programi studimi sic kriteri 1 e kërkon</p> <p>GVJ nuk konstatoi plan për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e PS Bsc. MT për një cikël të plotë studimi.</p> <p>(https://univlora.edu.al/raporti-financiar/).</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas</p>	<p>Referuar RVB dhe vizitës në institucion, rezultojnë se kërkesat buxhetore propozohen nga njësia bazë dhe ajo kryesore, organizohen në nivel institucioni dhe miratohen nga senati si dhe nga bordi i Administrimit. Të dhënat në të jepen për shpenzimet e planifikuara për financimin e burimeve njerëzore, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura etj.</p> <p>Për sa më sipër GVJ konstatoi se këto informacione jepen në nivel institucioni dhe jo në nivel program studimi.</p> <p>GVJ rekomandon që në të ardhmen institucioni vlerësojë mundësitë e paraqitjes së këtyre planeve të financimit në nivel njësie bazë dhe program studimi, sic kriteri 2 e kërkon.</p>

natyrës specifike të tij.				
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	UV si institucion publik i arsimit të lartë, auditohet financiarisht në disa forma. Institucioni i nënshtrohet auditimit të brendshëm, i cili monitoron ecurinë e proceseve shpenzuese/investuese dhe lejon të kryhen rregullimet e duhura për efektivitetin e këtyre proceseve. Përveç auditimit të brendshëm, UV auditohet nga Ministria e Arsimit Sporteve dhe Rinisë si dhe nga KLSH. Për rekomandimet e dy institucioneve të fundit institucioni ka detyrimin e hartimit të një plani masash për përmbushjen e tyre.			
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	GVJ konstaton në DVV, se institucioni ka depozituar raportet vjetore të viteve 2017-2018 dhe të 2018-2019 dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe për të ardhmen nga takimet on-line, planifikon edhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Referuar raportit vjetor si dhe RVB, rezulton se UV si institucion publik, siguron të ardhurat nga granti për mësimdhënien si dhe nga të ardhurat nga tarifat e studentëve. Në kushtet e zvogëlimit të numrit të studentëve si rezultat i rritjes së mesatares, por edhe faktorëve të tjerë, GVJ është e mendimit se UV duhet të sigurojë forma alternative të gjenerimit të fondeve në të ardhmen nga projektet e financuara nga AKSHI, projekte të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, duke konsideruar edhe resurset turistike dhe humane që rajoni ka dhe që mund të rrisin atraktivitetin, për financuesit e këtyre projekteve etj.			
	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.I

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe

diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>GVJ konstaton se UV ka një sërë rregulloresh dhe procedurash duke filluar nga niveli institucional në tërësi e deri tek departamenti apo programi i studimit që mbulojnë një cikël të plotë 3 vjecar nga hyrja deri në diplomim të studentëve në PS Bsc MT. Këto procedura janë të sanksionuar respektivisht në nenin 39 të rregullores së UV dhe në kreun IV të rregullores së Departamentit të Biznesit.</p> <p>Orientimi dhe këshillimi i studentëve nis nga momenti i informimit për programet akademike për maturantët, gjatë muajit mars të cdo viti dhe deri pas përfundimit të studimeve nga ana e tyre.</p> <p><i>(54 Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf, Evidenca 2.5.PDF DVV)</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ referuar evidencave si dhe informacionit gjatë takimit me studentët e PS në Bsc MT është e mendimit se aktet rregullatore ku sanksionohen politikat dhe procedurat që ndiqen nga hyrja në dalje e studentëve në PS në UV, ofrojnë trajtimin e drejtë dhe të barabartë të studentëve mbështetur mbi meritokracinë. Refruar këtu politikave të pranimit, atyre të frekuentimit, të ankimimit si dhe të vlerësimit të arritjeve akademike të studentëve</p> <p><i>(54 Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf, Evidenca 2.5.PDF Evidenca 2.8 DVV)</i></p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>GVJ konstaton se kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së studentëve janë të publikuara në webin zyrtar të UV dhe mund të aksesohen nga të gjithë të interesuarit.</p> <p>Gjithashtu rregullorja për vlerësimin, transferimin etj, gjenden në webin e UV dhe mund të aksesohen në cdo kohë.</p> <p><i>(https://univlora.edu.al/2017/10/10/kriteret-e-pranimit-per-tu-rregjistruar-ne-programet-e-ciklit-te-parë-te-studimeve-per-vitin-akademik-2017-2018-brenda-dates-20-10-2017/) (https://univlora.edu.al/rregullorja/)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Referuar takimeve on-line, me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë si dhe informacionit në DVV, rezulton se departamenti dhe fakulteti hartojnë përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p> <p>GVJ konstatoi se këto kriteret publikohen</p> <p><i>(Evidenca 2.5.PDF; Evidenca 2.6; Evidenca 5.2.pdf DVV (https://univlora.edu.al/2017/10/10/kriteret-e-pranimit-per-tu-rregjistruar-ne-programet-e-ciklit-te-pare-te-studimeve-per-vitin-akademik-2017-2018-brenda-dates-20-10-2017/))</i></p>
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të</p>	<p>Referuar takimit on-line, me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë, ata propozojnë kriteret dhe kuotat për PS Bsc MT, të cilat miratohen nga senati dhe i përcillen Ministrisë së Arsimit Rinisë dhe Sporteve.</p> <p>Përcaktimi i tyre për vitin 2019-2020, mbështetet ne VKM 295. 10.05.2019, Udhëzimit të MARS 10, 15.05.2019 dhe Udhëzimit 17 të MARS të 30.07.2019.</p>

huaj.	Kuotat për këtë program studimi për 2019-2020 janë 60 studentë, Realizimi i tyre është në masën 34 %. https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2019/07/vendim-nr-34.pdf			
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ gjatë takimit on-line, konstatoi se UV dhe strukturat e tij, organizojnë ditët informuese në shkollat e mesme të qytetit për të informuar publikun, por dhe për të promovuar ofertën akademike të programeve të studimit. Gjithashtu një formë tjetër rezultoi edhe zhvillimi i open days në mjediset e UV me qëllime informimin e maturantëve të interesuar dhe shpërndarja e broshurave informuese. (Evidenca 5.4; 5.5;5.6)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Nga takimet on-line si dhe nga DVV, GVJ konstaton se UV ofron informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret që duhet të ndiqen dhe procedurat e zbatuara për përparimin akademik të studentëve, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet rregullatore të brendshme, rregulloren e UV, rregulloren e Departamentit të Biznesit. GVJ vlerëson se ky informimin behet në forma alternative, fizikisht nëpërmjet sekretarisë mësimore, nëpërmjet sistemit UVMS, nëpërmjet webit të fakultetit. (5.4 Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf, Evidenca 2.5.PDF Evidenca 2.8 DVV)
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	GVJ Referuar takimit me drejtues të njësisë kryesore, rezulton se studentët në UV kanë të drejtën të transferojnë studimet e tyre në degë të ngjashme edhe brenda UV, transferim që realizohet vetëm në fillim të vitit. Departamenti luan një rol të rëndësishëm në këtë informim të studentëve, por ky informacion sigurohet edhe nëpërmjet uebit të UV Nga takimi me studentët dhe stafin akademik të programit, rezulton se në fillim të cdo semestri, pedagogët e lëndëve informojnë studentët për programin e lëndës, procedurat e kontrollit të dijës dhe skemën e vlerësimit të dijeve si dhe detyrimet lëndore për studentët. (Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf)
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	GVJ konstaton se UV, sanksionon në rregulloren e institucionit si dhe në rregulloren e programit, kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës të cilat janë të publikuara në web. Studentët përveç webit informohen edhe nga sekretaria mësimore, në lidhje me mundësinë e zhvillimit të temës së diplomës apo provimin e diplomës, e kondicionuar kjo nga nota mesatare

	e studentit në dy vitet e para. <i>(Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf)</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	GVJ konstaton nga konsultimi i informacionit në sistemin e ASCAL, si dhe nga takimet on-line, se UV planifikon dhe organizon aktivitete dhe takime informuese dhe “open days” informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit, Bsc në MT, kryesisht maturantëve nga shkollat e mesme të qytetit si dhe të qyteteve të tjera në jug të Shqipërisë <i>(Evidenca 5.5; Evidenca 5.6)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p> <p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p> <p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p> <p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të</p>	<p>GVJ konstatoi nga takimet on-line, me stafin e programit, sekretarinë dhe studentët së Departamenti i Biznesit, se institucioni informon studentët në lidhje me strukturën e organizimit të programit.</p> <p>Studentët informohen nga strukturat e mësipërme për strukturën e vitit akademik, për kalendarin e provimeve, për orarin mësimor.</p> <p>GVJ konstatoi se cdo pedagog gjatë javës së parë të cdo viti informon studentët për lëndën, syllabusin, temat literaturën dhe detyrimet akademike të cdo lënde.</p> <p>GVJ sugjeron që webi i UV të vendos në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese, sepse referuar gjendjes aktuale të webit ky informacion nuk ekziston ose është i pjesshëm/i paazhornuar. Gjithsesi nga komunikimi në institucion, webi zyrtar aktualisht është në proces ristrukturimi.</p> <p>GVJ rekomandon që informacioni në lidhje me modulet, lëndët, përmbajtjen dhe kreditet duhet të bëhet i aksesueshëm edhe në faqen web për të informuar edhe studentët jashtë institucionit</p> <p>Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij</p> <p>Nga takimi on-line, me përfaqësues të zyrës së këshillimit të studentëve dhe asaj të karrierës, rezultojnë se këto zyra zhvillojnë aktivitete për orientimin në tregun e punës, por këto aktivitete deri tani rezultojnë të pakta dhe sporadike.</p> <p>GVJ rekomandon që aktiviteti i këtyre zyrave të jetë më i organizuar, më</p>

informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	proaktiv, me frekuent, mbështetur në aktivitete të përshtatura me nevojat e studentëve sipas programeve të studimit, për të rritur mbështetjen institucionale për orientimin në tregun e punës të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p> <p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Nga takimet on-line me përfaqësues të sekretarisë, konstaton se UV harton dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në PS Bsc në MT. Këto të dhëna mbahen manualisht nga sekretaria si dhe në mënyrë elektronike në sitemin e informacionit UVMS, sipas procedurave që parashikohen në statutin e UV, neni 58 dhe 69 si dhe ne rregulloren e UV. Referuar rregjistrave themeltar rezultojn se:</p> <p>Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë, për vitin akademik:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2017-2018 22 studentë, - 2018-2019 29 studentë. - 2019-2020 20 studentë <p>Numri i studentëve të transferuar, për vitin akademik rezultojn:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2017-2018 1 student - 2018-2019 1 student - 2019-2020 0 studentë <p>Numri i studentëve të ripranuar, për vitin akademik rezultojn:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2017-2018 17 studentë - 2018-2019 20 studentë - 2019-2020 11 studentë <p>Numri i studentëve të cregjistruar, për vitin akademik rezultojn:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2017-2018 1 student - 2018-2019 1 student - 2019-2020 0 studentë <p>Vihet re një ulje e numrit të studentëve të regjistruar në program e studimit BA në MT. Nga takimet on-line, rënia e numrit të regjistrimeve, i atribuohet, vendosjes së mesatares për regjistrim në fakultet të maturantëve, si dhe faktorëve demografikë dhe argumenton se e ka objektiv stabilitetin e numrit të studentëve. GVJ vlerëson pozitivisht përpjekjet e institucionit, për të promovuar në mënyrë të</p>

	<p>vazhdueshme programin e studimit, jo vetëm në qytetin e Vlorës, por edhe në qytete të tjera të jugut, zhvillimin e open days, panairot e punës etj. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi (mesataren në hyrje), deri në diplomimin e tyre dhe rezulton se i analizon ato në analizat vjetore</p> <p>GVJ gjatë takimit on-line me përfaqësues të sekretarisë mësimore, konsultoi rregjistrat themelor ku çdo student është rregjistruar dhe ishte pajisur me numer matrikullimi.</p> <p>Gjithashtu GVJ konsultoi dosje të studentëve të rregjistruar, të cilat përmbanin dokumentacionin e duhur dhe të noterizuar, si diploma e shkollës së mesme, listë notash, fotokopje e kartës së identitetit etj.</p> <p><i>(Evidenca 10 Numri i Studenteve te ripranuar ne tre vite.PDF; Evidenca A-Statuti i UV-së.pdf; Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf) (Evidenca I- Raporti vjetor i UV per vitin 2017-2018.pdf, Evidenca J- Raporti vjetor i UV per vitin 2018-2019.pdf)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p> <p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>GVJ referuar të dhënave dhe rregjistrave që institucioni mban, konstaton se UV mban të dhëna të vazhdueshme për ecurinë e studentëve deri në diplomim, vlerësimet e tyre në cdo lëndë, rregjistrime këto që përveç procesverbaleve analitike të cdo lënde në hard copy dhe në soft copy, hidhen edhe në rregjistrat themeltar, si dhe në sistemin elektronik të UVMS. Këto forma të kombinuara të mbajtjes së të dhënave, GVJ i vlerëson pozitivisht, sepse rrisin sigurinë e ruajtjes së të dhënave, por edhe shpejtësinë e sigurimit të informacionit nga përdoruesit e autorizuar të sistemit.</p> <p>GVJ iu vu në dispozicion nga institucioni të dhëna për cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve të cilat rezultojnë se janë pjesë e analizave periodike që departamenti i Biznesit bën apo raporteve vjetore në nivel institucioni. GVJ nuk siguroi as nga RVB dhe as gjatë takimit-online, të dhëna për punësimin e studentëve të Bsc MT.</p> <p>Rrjeti Alumni rezultoi se ishte krijuar në vitin e fundit në nivel institucioni dhe ende ishte duke u azhornuar me të dhëna, vonesa në azhornim të ndikuara edhe nga situatë pandemike.</p> <p>GVJ rekomandon se njësi bazë në rakordim me strukturat e tjera duhet të sigurojnë të dhëna për punësimin e studentëve të diplomuar, gjithashtu strukturat e UV, duhet të jenë më proaktive në krijimin e lidhjeve më efektive, me sipërmarrës të strukturave hoteliere, agjencive turistike, dhomës së tregëtisë etj, për rritjen e punësimit të studentëve të diplomuar në PS në MT.</p> <p><i>(Evidenca A- Statuti i UV-së.pdf) (Evidenca 0.9.PDF, Evidenca I- Raporti vjetor i UV per vitin 2017-2018.pdf, Evidenca J- Raporti vjetor i UV per vitin 2018-2019.pdf)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>E drejta për përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese është e sanksionuar në LAL 80/2015, neni 98, 99 dhe në Statutin e UV, neni 74. GVJ konstatoi nga RVB dhe nga informacioni në faqen zyrtare të UV se janë zhvilluar zgjedhjet për këshillat studentorë të cilët tashmë kanë krijuar strukturat e tyre të dala nga zgjedhjet.</p> <p>Gjithashtu rezulton, studentët e UV janë të përfaqësuar në senat nga dy studentë dhe kanë edhe një përfaqësues të tyre në bordin e administrimit mbas riorganizimit të Bordeve të Administrimit.</p> <p>Përfaqësimi i tyre në këto nivele vendimmarrëse, krijojnë mundësinë e përfaqësimit të kërkesave të tyre në vendimmarrjen e UV.</p> <p>Referuar informacionit të siguruar nga takimet on-line, me përfaqësues të zyrës së Karrierës dhe Alumnit si dhe të zyrës së NJSBC, studentët kanë marrë pjesë aktive në procesin e shpërndarjes dhe të administrimit të pyetësorëve të studentëve.</p> <p>Gjithashtu studentët e programit rezultojnë të jenë të përfshirë edhe në grupin e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit, por përfshirja e tyre këtu duhet të jetë më aktive sidomos në fushën dedikuar studentëve</p> <p>GVJ gjatë takimit-online, konstatoi se institucioni, nëpërmjet një urdhëri të brendshëm për ngritjen e grupit për rishikimin e pyetësorit të studentëve, ka përfshirë këtu edhe studentë. Referenca në vijim:</p> <p><i>(Urdhër Nr. 123 datë 19.12.2019, per angazhimin e studenteve ne grupe Ad-Hoc.pdf; Vendim Senati 52 date 20.04.2017.PDF)</i></p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>GVJ konstaton se organizimi i PS Bsc në MT, është mbështetur në bazën ligjore respektive për përcaktimin e ngarkesën.</p> <p>GVJ konstaton se institucioni synon që procedurat e transferimit, të respektojnë aktet ligjore dhe nënligjore (Rregulloren dhe Statutin e UV) nga njëra anë, dhe nga ana tjetër të shmangin procedurat burokratike për ekuivalentimin e lëndëve për studentët që transferohen nga degë të përafërta të UV dhe nga universitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Nga takimi-online me përfaqësues të NJSBC, procedura joburokratike përfshijnë edhe ekuivalentimin e lëndëve të studentëve që kanë kryer mobilitete në kuadër të programit Erasmus+, ku ekuivalentimi behet mbi bazë të marrëveshjes së mobilitetit.</p> <p>Kjo praktikë është një praktikë e mirë që UV ka dhe mund të përdoret edhe për studentët e PS Bsc në MT në të ardhmen, të cilët deri tani nuk kanë kryer mobilitete të tilla, sipas informacionit të siguruar nga takimi-online me drehtues të zyrës së projekteve.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni</p>	<p>Nga takimi me drejtues të NJSBC, rezultoi se studentët përfshihen në</p>

<p>garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>procesin e përmirësimit të PS në Bsc MT, në mënyrë indirekte, nëpërmjet feedbackut që njësisë bazë merr prej pyetesorit të studentëve që zhvillohen dy herë në vit nga NJSBC</p> <p>GVJ vlerëson përfshirjen e studentëve në anketat e zhvilluar për vlerësimin e procesit mësimor, e cila rezulton të jëtë e vullnteshme dhe plotësimi është nëpërmjet faqes së UV. Gjithashtu GVJ gjatë takimit-online, konstatoi se institucioni, nëpërmjet një urdhëri të brendshëm për ngritjen e grupit për rishikimin e pyetesorit të studentëve, ka përfshirë këtu edhe studentë.</p> <p>Referenca në vijim: <i>(Urdhër Nr. 023 datë 09.02.2019, per angazhimin e studenteve ne grupe Ad-Hoc.pdf)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/ pedagogut përgjegjës.</p>	<p>GVJ konstaton se studentët kanë të sanksionuar në rregullore, të drejtën e ankimimit si dhe të drejtën e rishikimit të rezultateve të vlerësimit të tyre</p> <p>Referuar takimeve on-line, me stafin akademik dhe me studentët, mbas hedhjes së notave në sistemin UVMS, studentët kanë të drejtën e ankimimit të rezultatit, konsultimit me tezën e provimit e më pas pedagogu i lendës vendos notën përfundimtare. Nëse studenti serish e ankimon këtë rezultat, është dekani i cili ngrë një komision të ri për rishikimin e rezultatit.</p> <p>Gjithashtu nëpërmjet anketimeve semestrale, studentët kanë të drejtë të shprehin perceptimet e tyre, mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve.</p> <p>GVJ konstaton se provimet bëhen të pasekretuara, mbështetur kjo në rregulloren e institucionit. GVJ sugjeron që institucioni të vlerësojë mundësinë e rishikimit të kësaj praktike. Referuar praktikave të shumta të konsultuara, rezulton se procesi i sekretimit, rrit paanshmërinë në vlerësimin dhe ul mundësinë e paragjyqimit të procesit të vlerësimit nga studentët.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>GVJ konstaton se UV nëpërmjet njësisë të posaçme në strukturën organizative zhvillon procedura në shërbim të informimit të studentëve mbështetur në statutin edhe rregulloren e UV. Përsa më sipër është Sektori i Këshillimit të Karrierës Alumnit dhe Aktiviteve kulturore, që në bashkëpunim me njësinë kryesore dhe atë bazë informojnë studentët në mënyrë të vazhdueshme</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit</p>	<p>UV ka të ngritur dhe ka funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe</p>

<p>të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>programin e studimit, që kanë përbërje të tyre, struktura në nivel institucioni sic është, Sektori i Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, në nivel njësie bazë sic janë, sekretaria e Departamentit të Biznesit dhe Koordinatori për marrëdhëniet me studentët.</p> <p><i>(Evidenca A- Statuti i UV-së.pdf, neni 77, Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf neni 85) (Evidenca 5.6)</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p> <p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Referuar Statutit dhe Rregullores së institucionit janë të sanksionuara detyrat që Sektori i Këshillimit të Karrierës Alumnit dhe Aktiviteteve kulturore duhet të kryejne.</p> <p>GVJ konstatoi aktivitete informimi me maturantët, të kryer nga kjo zyrë mbi bazën e një kalendari paraprak, aktivitete informimi për studentët e vitit të parë, gjithashtu të aktiviteteve trajnuese/informuese, sic është shkrimi i një CV.</p> <p>Pavarësisht për sa më sipër, GVJ është e mendimit se Sektori i Këshillimit të Karrierës Alumnit dhe Aktiviteteve kulturore, duhet të planifikojë dhe të organizojë në mënyrë të vazhdueshme dhe më të shpeshtë, aktivitete informuese dhe orientuese për studentët, në lidhje me praktikën profesionale dhe punësimin e tyre të ardhshëm. Rekomandohet një kombinim më i përshtatshëm midis aktivitetit të zyrave administrative dhe sistemit të këshillimit në bazë të secilit departament. Kjo do të mundësojë ngritjen e një sistemi më efektiv të informimit, këshillimit dhe asistencës së vazhdueshme për studentët në lidhje me praktikën profesionale apo me punësimin e ardhshëm, apo për ndarjen e eksperiencave të studentëve në mobilitete në kuadër të programit Erasmus+ etj, një ngarkesë më të balancuar të burimeve njerëzore të këtij sektori dhe në shërbim të programeve të vecanta të studimit, sic është Bsc MT</p> <p>GVJ konstatoi se UV ka krijuar prej një viti Rrjetin Alumni, i cili është në azhurnim e sipër. GVJ sugjeron që zyra përgjegjëse të intensifikojë përpjekjet dhe të diversifikojë mekanizmat për plotësimin e rrjetit Alumni të Menaxhim Turizmi, si dhe të përpunojë dhe analizojë të dhënat mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit</p> <p><i>(Lista e aktiviteteve të Zyres së Marrëdhënieve me Publikun.pdf; Evidenca 5.6)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.I	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>GVJ referuar DVV si dhe takimeve në institucion konstaton se UV ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimin Institucional, përgjegjësitë e të cilës janë sanksionuar në statutin dhe rregulloren e UV.</p> <p>Struktura e NSBCI në UV është një strukturë relativisht e re e cila në me vendim Senati në 14.02.2018 është riorganizuar. GVJ nuk siguroi të dhëna të mëhershme për aktivitetin e NJSBC</p> <p>Stafi aktual i njësisë përbëhet nga 4 anëtarë staf administrativ me një kohëzgjatje në detyrë prej dy vitesh deri tani.</p> <p>NJSBCVI funksion në bazë të strategjie institucionale e cila konsiston në procedurat për vlerësimin e pyetësorëve të studentëve</p> <p>Këto procedura parashikojnë plotësimin e një pyetësori të miratuar nga senati, dy herë në vit, para fillimit të sezonit të provimeve dhe nxjerrjen e rezultateve pas daljes së rezultateve të studentëve.</p> <p>Aplikimi bëhet on-line dhe perfshirja e studentëve është e vullnetshme, sikurse konfirmuan studentët gjatë takimit on-line me ta, në ndryshim nga RVB që i referohet pjesëmarrjes së ë të gjithë studentëve.</p> <p>NJSBCVI i përpunon pyetësorët dhe rezultatet i përcillen rektorit i cili ia përcjell njësisë kryesore e më tej njësisë bazë. Mbas analizës së të dhënave të pyetësorëve, njësitë bazë dhe ato kryesore propozojnë masat për përmirësimin e problematikave të identifikuara, të cilat formalizohen më tej në nivel institucioni. Raporti final bashkë me planin e masave miratohet nga senati.</p> <p>GVJ konstaton se në menaxhimin e pyetësorëve të studentëve marrin pjesë studentë të fakulteteve të ndryshme</p> <p>GVJ konstatoi gjatë takimit on-line, se NJSBC ka një plan vjetor aktivitetesh, për promovimin dhe sigurimin e cilësisë</p> <p><i>(Evidenca 8. Aktivitete disiminuese per cilesine.pdf; Evidenca A- Statuti i UV-së.pdf, nenet 81, 82, 83), (Evidenca 1.7), (Tabela 24, RVB), (Evidenca 6.1; Evidenca 3.1.pdf)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimin të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të</p>	<p>GVJ konstaton se pyetësori është i përbërë nga 14 pyetje të cilat bëjnë një vlerësim të përgjithshëm të programit të studimit që siguron informacion të rëndësishëm për ecurinë e programit Ba në MT</p> <p>Po kështu nga konsultimi i pyetësorit për matjen e performancës së pedagogut, konstatojmë që mënyra se si ky pyetësor është hartuar, vështirëson matjen e performancës. Fushat që do të vlerësohen dhe indikatorët përkatës nuk janë të qarta, për të arritur në rezultate të</p>

<p>tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>përdorshme, në lidhje me performancën e stafit akademik ose jo akademik.</p> <p>GVJ rekomandon përdorimin e mekanizmave të tjerë alternativë, si fokus grupe me studentë, vetëvlerësim të stafit, vlerësim të stafit akademik për kapacitetet institucionale etj, vlerësim të studentëve për kapacitetet infrastrukturale etj.</p> <p>Mekanizmat e mësipërm do të realizonin një vlerësim 360 grade, për të identifikuar qartësisht dhe saktësisht problematikat, si dhe për të adresuar në mënyrë korrekte zgjidhjet</p> <p>Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të licencimit, të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. Në këtë kuadër, UV është akredituar për një periudhë tre vjecare dhe tani është në proces riakreditimi.</p> <p><i>(Vendim Senati 52 date 20.04.2017.PDF)</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi VI.2</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ referuar strukturës organizative dhe takimeve on-line, konstaton se në UV Sektori i Kurrikulave, është njësia e posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p> <p>Referuar takimeve on-line, me stafin akademik, drejtues të njësisë bazë dhe përfaqësues së zyrës së kurrikulave, rezulton se kjo strukturë, bën një kontroll të përgjithshëm, duke iu qëndruar kryesisht sugjerimeve që departamenti sjell. Referuar sugjerimeve që GVJ dha për planin mësimor në cilësi dhe në shpërndarje kreditesh, GVJ sugjeron që kjo njësi të rrisë nivelin e mbikëqyrjes dhe të rishikimit, për të pasur kurrikula të të mirëstudiuara, konsoliduara dhe bashkëkohore.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Institucioni për PS Bsc MT, ndjek procedura formale dhe të rishikimit të programit Bsc në MT, të cilat janë të dokumentuara</p> <p>Sektori i Kurrikulës, orienton, vlerëson dhe monitoron nëse hartimi i PS është në përputhje me bazën ligjore respektive dhe nëse procedurat për miratimin e tyre janë të duhurat.</p> <p><i>(Evidenca 2.12.PDF)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe</p>	<p>UV përdor metodologji vlerësimi mbështetur kryesisht tek instrumenti i pyetësorit prej të cilit synon të sigurohet një feedback për ecurinë e PS. Pyetësorë të tillë janë aplikuar për dy vite 2017-2018 si dhe 2018-2019,</p>

<p>mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>duke qenë se NJSBCVI është një strukturë relativisht e re</p> <p>GVJ rekomandon përdorimin e mekanizmave të tjerë alternativë si fokus grupe me studentë, vetëvlerësim të stafit, vlerësim të stafit akademik për kapacitetet institucionale etj, vlerësim të studentëve për kapacitetet infrastrukturale etj.</p> <p><i>(Evidenca L- Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor per vitin akademik 2018-2019.pdf)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p> <p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>GVJ konstaton se rezultatet e pyetësorëve të studentëve dokumentohen dhe i përcillen drejtuesve të njësisë kryesore dhe asaj bazë, për shqyrtim të problematikave, identifikim të praktikave të mira dhe propozimin e masave për përmirësimin e cilësisë dhe adresimin e problemeve. Njësia bazë dhe ajo kryesore analizojnë gjetjet e pyetësorëve dhe hartojnë një plan masash të nevojshëm për përmirësimin e situatës</p> <p>GVJ nuk hasi në një raport vlerësues për zbatimin e masave të lëna për vitin 2017-2018 dhe për vitin 2018-2019. GVJ rekomandon që institucioni të ndjek zbatimin e masave, të propozuara nga njësitë kryesore dhe të miratuara nga senati për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. <i>(Evidenca L- Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor per vitin akademik 2018-2019.pdf; Evidenca 6.4.pdf)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi VI.3</p> <p>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Vlerësimi i brendshëm i PS Bsc në MT, rezulton të bëhet për herë të parë, në kuadër të këtij akreditimi programor.</p> <p>Vlerësime të pjesëshme, janë bërë dy vitet e fundit akademike nëpërmjet pyetësorëve të organizuar nga NJSBCVI</p> <p>GVJ rekomandon që në akreditim e ardhshëm institucional të përfshihen edhe informacionet e vlerësimit programor, sic është edhe vlerësimi programor i PS Bsc në MT</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p> <p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e</p>	<p>Për vlerësimet semestrale sikundër është trajtuar edhe në standardet më herët, UV përdor si instrument pyetësorin.</p> <p>GVJ mbështet idenë e përdorimit të mekanizmave të ndryshëm të vlerësimit, mbështetur në praktikat më të mira, të instucioneve të tjera vendase apo të huaja.</p> <p>Referuar RVB, UV përdor metoda të drejtëpërdrejta vlerësimi</p>

<p>cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>GVJ gjatë takimeve on-line, siguroi informacin për vlerësimin e performancës së stafit në disa drejtime si për syllabusin, literaturën, për pjesëmarrjen në kërkimin shkencor dhe projekte, për procesin mësimor etj.</p> <p>GVJ inkurajon që institucioni t’i referojë këto mekanizma në vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit në përmbushje të këtyre kritereve dhe t’i dokumentojë ato.</p> <p>(Evidenca7. Vleresimi i performances se Stafit Akademik.PDF)</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>UV përdor si instrument kryesor pyetësorin, dy herë në vit në përfundim të cdo semestri, për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies</p> <p>Në lidhje me praktikat e tjera dhe instrumentat e tjerë të tërthortë në kriterin 4, UV nuk ka vënë në dispozicion procedura të anketimit të stafit akademik dhe ndihmës akademik si edhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit nëpërmjet grumbullimit të informacionit nga ish studentët, bashkëpunëtorët e programit të studimit etj.</p> <p>GVJ gjykon që institucioni duhet t’i përfshijë në të ardhmen edhe këto instrumentë, si dhe të krijojë një bazë të gjerë e periodike informacioni, si edhe mënyra të krahasueshme të përpunimit të informacionit, me qëllim krahasueshmërinë e tij nga një vit në tjetrin, nga informacioni i marrë nga stakeholdersit e mësipërm.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton</p>	<p>GVJ konstaton se UV ka NJSBVI, një njësi qendrore në nivel institucioni me një staf administrativ prej 4 anëtarësh, drejtor drejtorie, përgjegjës si dhe 2 specialistë, të cilët kanë të sanksionuar në statut detyrimin për performimin e procedurave për sigurimin brendshëm të cilësisë.</p> <p>Procedura e analizës së pyetësorëve dhe ndarja e detyrave e rezultojnë e përcaktuar me vendimin 21 të Senatit Akademik të 21.05.2018. Rezultojnë të përfshirë në këtë proces, NJSBVI, Senati, Rektori dhe Dekanati.</p> <p>UV ka organizuar në trajtën e një tavoline të rumbullakët pjesëmarrësit, një workshop kryesisht me Institucione Publike si Zyra e Punës, Drejtoria e Tatimeve, Prefektura, Zyra Arsimore, Dhoma e</p>

<p>ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p> <p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p> <p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> <p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Tregtisë, Përfaqësues i Shoqatës së Operatorëve Turistik në Vlorë, drejtues të Bankave ë Nivelit të Dytë në Qytetin e Vlorës etj.,</p> <p>Për sa më sipër GVJ sugjeron që rekomandimet e dala nga këto tryeza, të vlerësohen nga institucioni dhe të përfshihen në procesin e përmirësimit të programeve të studimit.</p> <p>Pyetësorët zhvillohen on-line, kështu ruhet anonimiteti i përgjigjeve të studentëve. Diskutimet zhvillohen mbi problematika duke shmangur diskriminimi apo pabarazinë kundrejt stafit akademik dhe studentëve</p> <p>Pavarësisht se NJSBCVI ka detyrimin institucional për ndjekjen e procedurave për sigurimin e Brendshëm të cilësisë, gjetjet dhe analizat janë të përgjithshme, ato nuk analizohen në nivel program studimi. Në këtë kuadër GVJ, sugjeron një përfshirje më të madhe të njësisë kryesore dhe të njësisë bazë në menaxhimin e proceseve për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe në specifikimin e tyre në nivel programor, ndërkohë që NJSBCVI ndjek procesin në nivel institucional</p> <p>Për këtë rekomandohet që anëtarë të njësisë bazë, përfaqësues të studentëve të programit, dhe përfaqësues të stakeholdersve të jashtëm të jenë pjesë e një grupi adhoc për sigurimin e cilësisë në nivel njësie bazë dhe në nivel programor</p> <p>Sikurse paraqitet edhe në RVB, institucioni demonstroi shembull workshop, të organizuar me përfaqësues të biznesit. GVJ e konsideron një start të mirë për t'i përfshirë partnerët e tregut të punës në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programeve, por ende ato nuk janë të orientuara, për programe të vecanta si Bsc në MT, ose ende nuk kanë prodhuar informacione për përmirësimin e ps Bsc në MT.</p> <p>GVJ nuk gjeti evidenceë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë, për përfshirjen e stakeholdersve të jashtëm me fokus përmirësimin e cilësisë së programeve, edhe të PS BA MT, si p.sh të Përfaqësuesve të bizneseve hoteliere, të dhomës së tregëtisë, të institucioneve publike, vendimmarrës lokal etj.</p> <p>GVJ ashtu sikurse edhe GVB, është e mendimit se ende mungojnë instrumentat e strukturuar dhe efektivë, për sigurimin e informacionit në mënyrë sistematike nga këta stakeholders' të rëndësishëm. Rekomandimet e tyre do të konsiderohen shumë të rëndësishëm, duke parë rëndësinë e zhvillimit të turizmit, potencialet e tij në rajonin e jugut, kërkesët për punonjës të kualifikuar nga tregu i punës, dhe nga ana tjetër tkurrjen e vazhdueshme të numrit të studentëve. në këtë degë prioritare për UV</p> <p><i>(Evidenca A- Statuti i UV-së.pdf (neni 81, 82, 83); Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf (neni 86)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> <p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>GVJ referuar DVV dhe webit zyrtar të UV, konstaton se politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. Vendimet e senatit si dhe raporti i analizës së pyetësorëve të studentëve, rezultojnë të publikuar në faqen zyrtare.</p> <p>Raporti respekton lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> <p>Rezulton se njësia bazë, ka propozuar plan masash për adresimin e problematikave, por jo në nivel programor.</p> <p>GVJ sugjeron që në të ardhmen, këto të fokusohen në nivel programor dhe të jene më specifike.</p> <p><i>(https://univlora.edu.al/2019/12/11/publikimi-i-%20raportit-te%20analzes-se%20pyetesorit-te%20studenteve)</i></p> <p><i>(Evidenca K- Raport mbi rezultatet e pyetesorit studentor per vitin akademik 2017-2018.pdf; Evidenca L- Raport mbi rezultatet e pyetesorit studentor per vitin akademik 2018-2019.pdf)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB, NJSBCVI raporton në mënyrë të vazhdueshme në senat për procesin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë.</p> <p>GVJ rekomandon që institucioni të ndjek zbatimin e masave të propozuara nga njësitë kryesore dhe të miratuara nga senati për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga takimi on-line me NJSBCVI rezulton se UV nëpërmjet NJSBCVI organizon veprimtari me stafin akademik dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre, për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>(Evidenca 8 Aktivitete disiminuese per cilesine.pdf)</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Menaxhim Turizmi” të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Niveli i kualifikimit të stafit akademik, në tërësinë e tij stafi akademik është me grada dhe tituj dhe me eksperiencë.
2. Mbulimi i mësimdhënies me pedagoge të brendshëm, gjë që rrit angazhimin e stafit të specializuar me përvoja aplikative në fusha të caktuara.
3. Staf akademik dhe administrativ i motivuar dhe i përkushtuar për t’i ofruar studentëve një shërbim sa më cilësor.
4. Hartimi i udhëzuesit për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies, në nivel institucional, ku fokusi është në implementimin e modelit “Studenti në Qendër”.
5. Sistemi i manaxhimit të informacionit të institucionit, rezulton një sistem efektiv në shërbim të përdoruesve dhe të institucionit.
6. Procedura e transferimit të studentëve është fleksibile, duke qenë se programet e Fakultetit të Ekonomisë, kanë ngjajshmëri të lartë në vitet e para, duke krijuar mundësi të larta transferimi për ta.
7. Lokacioni dhe vendodhja e Universitetit në zonë me akses të lartë.
8. Praktikrat motivuese të financimit të kostove individuale për kërkimin shkencor të stafit akademik.

Pika të dobta:

1. Mungojne ne planin mësimor module që lidhen me thellimin e njohurive në aspektin praktik të menaxhimit të aktiviteteve të turizmit, sidomos atij lokal, që do të plotësonin nevojat e kohës në zhvillimin e turizmit
2. Literaturë e kufizuar në gjuhën shqipe, ndërkohë kur, për studentët e sistemit Bachelor, nuk është e detyrueshme gjuha e huaj.
3. Numër relativisht i kufizuar i studentëve, gjë që zvogëlon mundësitë e përzgjedhjes cilësore të studentëve.
4. Mos përfshirje e studentëve të programit të studimit Bachelor në “MenaxhimTurizmi” në projektet e mobilitetit përmes bursave Erasmus.
5. GVJ konstaton se, bashkëpunimi me aktorët e biznesit vendas, i programit Bachelor në “MenaxhimTurizmi”, është vetëm në kuadër të praktikave profesionale dhe mungojnë bashkëpunimet alternative për krijimin e lidhjeve më efektive me sipërmarrësit e fushës së turizmit dhe vendimmarrësit lokalë, për punësimin e studentëve të programit si dhe për sigurimin e feedback-ut të rëndësishëm për përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit, sipas kërkesave bashkohore të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit.
6. Kushtet infrastrukturore fizike dhe të teknologjisë në shërbim të mësimdhënies në auditore nuk janë shumë të përshtatshëm.

7. Provimet nuk zhvillohen në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim.
8. Për bibliotekën:
 - a. Hapësirat e bibliotekës së institucionit janë të vogla dhe të pamjaftueshme, duke konsideruar numrin e studentëve që studiojnë në institucion si dhe nevoja e paplotësuar për një gamë më të gjerë librash në gjuhën shqipe dhe angleze, revistash shkencore, periodikë, si dhe me shume literaturë bashkohore për programin e studimit PS në Bsc në Menaxhim Turizmi
 - b. Nivel i ulët i shfrytëzimit të bibliotekës nga studentët
9. Faqja e internetit nuk është shumë interaktive dhe nuk siguron decentralizim në nivel fakulteti.
10. Nuk ka diversifikim të fondeve nga burime alternative
11. Mekanizmat e sigurimit të brendshëm të cilësisë janë të padiversifikuar.

Rekomandime:

1. Të shprehen qartë objektivat formuese të programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Turizmi” si dhe struktura e tij të orientohet më mirë nga nevojat e tregut të punës.
2. Të shikohet mundësia e ristrukturimit të programit në drejtim të:
 - zëvendësimit të disa moduleve të tilla si: *Strategjia e Turizmit dhe Ekonomia e Ambjentit*, të cilat nuk mund të jenë lëndë karakterizuese të programit për këtë nivel studimesh.
 - unifikimit të emërtimeve të disa lëndëve (*Ndërmarrjet Turistike apo Ndërmarrjet Turistike Pritëse*, etj.) në syllabuset përkatëse dhe në planin mësimor.
 - mundësisë së riorganizimit të planit mësimor, pasi lëndët *Ekonomia e Ambjentit dhe Turizmi i Qendrueshëm dhe Marketing Territori dhe Turizëm Ndërkombëtar* si dy lëndë të programit ekzistues, përbëjnë objekt studimi të katër lëndëve të veçanta.
 - plotësimit të disa lëndëve, sidomos atyre të fushës së turizmit me literaturën bazë në gjuhën shqipe dhe të rifreskohet literatura e huaj me botime të viteve të fundit.
3. Rekomandohet realizimi i raportimeve dhe analizave në strukturat dhe njësitë përgjegjëse, nga stafi akademik, me qëllim përgjithësimin e përvojave të fituara në përdorimin e metodave të reja të mësimdhënies nga mobiliteti përmes bursave Erasmus + dhe programeve të tjera bilaterale.
4. GVJ rekomandon publikimin e thirrjeve për punësim edhe ne burime të tjera alternative sic është faqja e APP, apo media vizive dhe e shkruar duke i shërbyer kështu shpërndarjes së informacionit në shkallë më të gjerë, duke rritur visibilitetin e thirrjes për të rritur numrin e aplikantëve cilësore.
5. Strukturat e UV, duhet të jenë më proaktive në krijimin e lidhjeve më efektive me sipërmarrësit, dhe vendimmarrësit lokal, për rritjen e numrit të bizneseve si dhe inkorporimin e një bashkëpunimi sinergjik, për të mundësuar si zhvillimin e praktikave sa më efektive si dhe rritjen e punësimit të studentëve të diplomuar në PS në Menaxhim Turizmi.
6. UV duhet të zgjerojë fondin e bibliotekës me nje gamë më të gjerë librash në gjuhën shqipe dhe angleze, revistash shkencore, periodikë, si dhe më shumë literaturë bashkohore për programin e studimit PS në Bsc në Menaxhim Turizmi dhe duhet të sigurohet një ndërgjegjësim i studentëve për përdorimin e bibliotekës dhe të data bazës së saj.
7. UV të vlerësojë mundësitë, për gjenerimin e fondeve nga burime alternative siç është aplikimi dhe pjesëmarrja në projekte me financues të ndryshëm, për të diversifikuar burimet e të ardhurave, në

kushtet kur numri i studentëve si dhe të ardhurat nga tarifat studentore për këtë program, kanë ardhur duke u zvogëluar

8. Rekomandohet një kombinim më i përshtatshëm midis aktivitetit të zyrave administrative dhe sistemit të këshillimit të studentëve, në bazë të secilit departament. Kjo do të mundësojë ngritjen e një sistemi të më përshtatshëm të informimit, këshillimit dhe asistencës së vazhdueshme për studentët në lidhje me praktikën profesionale apo me punësimin e ardhshëm, apo për ndarjen e eksperiencave të studentëve në mobilitete në kuadër të programit Erasmus+ etj.
9. UV të vlerësojë mundësinë e aplikimit të sekretimit të provimeve, sepse pavarësisht kohës fizike dhe ngarkesës fizike që do të kërkonte procesi i sekretimit dhe c'sekretimit, refruar praktikave të shumta të konsultura, rezulton se ai rrit paanshmërinë në vlerësimin dhe ul mundësinë e paragjykitimit të procesit të vlerësimit nga studentët.
10. Rekomandohet përdorimi i mekanizmave alternativë si fokus grupe me studentë, vetëvlerësim të stafit, vlerësim të stafit akademik për kapacitetet institucionale etj. Anëtarë të njësisë bazë, përfaqësues të studentëve të programit, dhe përfaqësues të stakeholders-ve të jashtëm të jenë pjesë e një grupi ad-hoc për sigurimin e cilësisë në nivel njësie bazë dhe në nivel programor.

Conclusions of the Evaluation of the study program of the first cycle, Bachelor in “Tourism Management”, “Ismail Qemali” University, Vlora.

Strengths and affirmations:

1. Level of qualification of the academic staff. On the whole the academic staff is with degrees and titles and with experience.
2. The level of coverage of teaching with internal lecturers, which increases the engagement of specialized staff, with applied experience in certain fields.
3. Academic and administrative staff are motivated and dedicated to provide students with the highest quality service.
4. Designing a guide at the institutional level for the development and use of various innovative teaching methods where the focus is on the implementation of the model "Student in the Center"
5. Effective information system
6. Flexible and non-bureaucratic student transfer procedure
7. Location of the University, that is in an area with high access
8. Motivational practices of financing individual costs for scientific research of academic staff

Weak points:

1. The curriculum lacks some modules related to the deepening of knowledge in the practical aspect of the management of tourism activities, especially the local one, which would meet the needs of the time in the development of tourism
2. Limited literature in Albanian language, while, for students of the Bachelor system, a foreign language is not mandatory.
3. Low number of students, which reduces the possibilities of quality selection of students.

4. Non-involvement of students of the Bachelor study program in "Tourism Management" in mobility projects through Erasmus scholarships.
5. EEG finds that the cooperation with local business actors of the program in question is only in the framework of professional practices.
6. Physical and technological infrastructure conditions in the service of teaching in auditoriums not very suitable
7. Exams are not conducted anonymously with secretion or codification.
8. For the library:
 - a. The library space of the institution is small and insufficient, considering the number of students studying in the institution and the unmet need for a wider range of books in Albanian and English, scientific journals, periodicals, as well as more literature. Contemporary for the SP study program at Bsc in "Tourism Management".
 - b. Low level of use of library from students
9. The website is not very interactive and does not provide decentralization at the faculty level.
10. There is no diversification of financial funds from alternative sources
11. Non-diversified internal quality assurance mechanisms

Recommendations:

1. EEG recommends clear declaration of the formative objectives of the bachelor study program in "Tourism Management" and its structure to be better oriented by the needs of the labor market.
2. EEG recommends the consideration of the possibility of restructuring the program in terms of:
 - a. replacement of some modules such as: Tourism Strategy and Environmental Economics, which can not be characteristic of the program for this level of study.
 - b. unification of the names of some subjects (Tourist Enterprises or Host Tourist Enterprises, etc.) in the respective syllabi and in the curriculum.
 - c. the possibility of reorganizing the curriculum, because the courses Environmental Economics and Sustainable Tourism and Marketing Territory and International Tourism, which are currently two courses of the existing program, are the subject of study of four separate courses.
 - d. Completing some courses, especially those in the field of tourism with basic literature in the Albanian language and updating foreign literature with publications of recent years.
3. It is recommended to carry out reports and analyzes in the responsible structures and units, by the academic staff, in order to generalize the experiences gained in the use of new teaching methods from mobility through Erasmus + scholarships and other bilateral programs. EEG recommends the publication of calls for employment in other alternative sources such as the PPA site, or visual and print media, thus serving the dissemination of information on a larger scale, increasing the visibility of the call to increase the number of quality applicants.
4. EEG recommends the publication of calls for employment in other alternative sources such as the PPA website, or visual and written media, thus serving the dissemination of information on a larger scale, increasing the visibility of the call to increase the number of qualitative applicants.
5. UV structures should be more proactive in creating more effective connections with entrepreneurs and local decision makers, to increase the number of businesses and to incorporate a synergistic

cooperation, to enable the development of more effective practices and increasing employment of SP graduate students in Tourism Management.

6. UV should expand the library fund with a wider range of books in Albanian and English, scientific journals, periodicals, as well as more contemporary literature for the SP study program in Bch in Tourism Management and should provide an awareness of students for the use of the library and its database.
7. UV should evaluate the possibilities, for the generation of funds from alternative sources such as application and participation in different projects, to diversify the sources of income, in the conditions when the number of students as well as the income from the student fees for this program, have been shrinking
8. A more appropriate combination between the activity of administrative offices and the student counseling system is recommended, based on each department. This will enable the establishment of a more appropriate system of information, counseling and ongoing assistance for students in relation to professional practices or future employment, or to share the experiences of students in mobility within the Erasmus + program, etc.
9. UV should evaluate the possibility of applying the secretion of exams, because despite the physical time and physical load that would require the process of secretion and non-secretion, refraining from numerous consulting practices, it turns out that it increases impartiality in assessment and reduces the possibility of prejudice of the assessment process by students.
10. It is recommended to use alternative mechanisms such as focus groups with students, staff self-assessment, evaluation of academic staff for institutional capacity, etc. Members of the core unit, student representatives of the program, and representatives of external stakeholders to be part of an ad-hoc group for quality assurance at the basic unit level and at the program level.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	